




Drita e Kur'anit



FLETUSHKË E SHOQATES SË NXËNËSVE TË MEDRESESË SË MESME "ALAUDDIN" NË PRISHTINË

MEDRESEJA E MESME
SREDNJA MEDRESA
„ALAUDDIN”
PRISHTINË PRISTINA

Fjala e kryeredaktorit

Lavdia dhe falenderimi i takon vetëm All-llahut xh.sh. i Cili krijoi gjithësinë dhe caktoi sistemin për mirëvajtjen e saj. Përshëndetjet dhe paqa qofshin për Muhammedin a.s. të cilin All-llahu i lartësaur e zgjodhi Pejgamber për udhëzimin e tërë njerzimit dhe të përfundojë misioni Hyjnorë të dërguarve dhe shpalljeve të All-llahut xh.sh.

Në duart tuaja keni numrin e shtatëmbëdhjetë të fletushkës sonë "Drita e Kur'anit".

Përpyjekjet tona rreth kësaj fletushke modeste Islame do të jenë fryte të kënaqshme për të eturit e diturisë Islame.

Besojë se karakteri i "Drites së Kur'anit", do të bëjë që ajo të jetë burimi i pashterrshëm i mësimave Islame, që do të kontribuojnë për formimin e personalitetit të një muslimani, të pjekur dhe të gatshëm, që të angazhohet në zgjidhjen e problemve të botës bashkohore.

Synimet më të larta të kësaj fletushke janë edhe edukimi i brezit të ri në frymën e shëndosh Islame dhe largimin prej disa botkuptimeve që nuk i përkohjnë Islamit.

Është e vërtetë e pamoshueshme se njerëzimi sot gjendet në një shkallë të lartë të zhvillimit shkencor-technik.

Këto arritje të shumta që po realizohen kohëve të fundit në aspektin shkencor, i hapën njerëzimit shtigje të reja në jetën e kësaj bote.

Faktori kryesor dhe bartësi aktiv i këtij progresi, padyshim është krijesa më e çmuar mbi sipërfaqen e tokës, e ky është njeriu.

Ata të cilët e harruan intuitën e vet, u dhanë me të madhe pas botës materjale, duke harruar aspektin shpirtëror andaj mbeten injorantë të mëdhenjë në besimin e tyre.

Ata që janë të këtij kalibri, Islamit duhet t'ua parashtrojmë ashtu siq na mëson All-llahu dhe i Dërguari i Tij s.a.v.s.. Ta shërojmë pacientin pa demtuar trupin. Njeriu qetësin

Botues: Shoqata e nxënësve të Medresës së Mesme "Alauddin" Prishtinë

Kryeredaktor: **Fatmir Latifaj**

Këshilli redaktues: Driton Morina, Shaban Murati, Ilir Osmani, Agron Tërziqi, Murat Gallopi, Halil Avdulli, Usame Morina, Burim Biba.

Lektor dhe korrektor: Jusuf Gashi

Përpunimi kompjuterik: **shulli**

Fletushka del sipas mundësisë

Adresa: Redaksia e "Nurit", f.p. 89. Prishtinë

Tel. 038/32472 & 32-473

është lejuar botimi i fletushkës "NUR-UL-KUR'AN" me vendimin e Sekretariatit për informata të Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv nr. 01-650-64 të dt. 18.03.1973 në Prishtinë

Dorëshkrimet dhe fotot, nuk kthehen

shpirtërore mund ta gjejë vetëm në fenë e All-llahut të lartësuar - Islame.

E vërteta qëndron në atë se ngritja e vetëdijes për rolin e Da'wetit (thirrjen) në përhapjen dhe mbrojtjen e urtësive dhe porosive të fesë sonë të shenjtë dhe çrrënjësjes e padrejtësive, duhet të jetë në nivel më të ngritur. Ky obligim i takon secilit që është natarë i familjes së madhe Islame, në veçanti prijësve fetar.

Edhe ne nxënësit e Medreses "Alauddin", krahas aktiviteteve të shumta edhe nëpërmjet kësaj fletushke, jemi përpyjekur që sado pak ta japim kontributin që na takon në këtë drejtim.

Në këtë numër do të prezentojmë tema të ndryshme që në vete mbajnë tematika e njohuri nga këndet e pashterrshme të Burimeve të fesë sonë - Kur'anit dhe hadithit.

Jamë i vetëdijshëm se pregatitja jonë profesionale në hartimin dhe shtjellimin e temave të këtij lloji është në formën e sipër, por megjithatë, brenda mundësive jemi përpyjekur të japim kontributin tonë edhe me rastin e botimit të këtij numri të fletushkës tonë "Drita e Kur'anit", që e keni në duart tuaja, njëherit të bëhet joshëse dhe e afërt për ju lexues të nderuar.

E falenderoj All-llahun xh.sh. që "Drita e Kur'anit" në të ardhmen e saj, do të jetë sa më e kompletuar duke u pajisur me tema të freskëta me përmbajtje fetare dhe aktuale.

Me respekt të thellë e presim çdo bashkëpunim dhe vërejtje, të cilat për në do të jenë edhe mësim për pregatitjen e numrave të ardhshëm të fletushkës sonë "Drita e Kur'anit".

Ves-selamu Alejkum!

Fatmir Latifaj

Përmbajtja

Në prag të muajit të agjërimit, të pages dhe shpëtimit.....	3
Islami - sistem jete dhe nevojë e domosdoshme për njeriun.....	4
Feja Islame fe universale.....	6
Agjërimi i muajit të bekuar - Ramazanit.....	7
Namazi - kusht i dytë për të qenë musliman.....	8
Namazi largon prej të këqijave.....	9
Zekati obligim moral.....	10
Kur'ani libër hyjnor e jo vepër njerëzore.....	11
Besimi i pastër.....	14
Morali Islam.....	16
Pastërtia dhe mbrojtja e shëndetit.....	17
Singeriteti dhe rrena.....	18
Llukman Hakemi e këshillon të birin.....	20
Barazia mes njerëzve.....	21
Pendimi (teubeja) mënyrë e vetme e shpëtimit ..	22
Pyetje dhe përgjigje.....	23

NË PRAG TË MUAJIT TË AGJËRIMIT, TË PAQES DHE SHPËTIMIT

Jemi në prag të muajit të Ramazanit, muajit në të cilin mbretëron paqja, mëshira, solidariteti dhe falja e Zotit xh.sh.

Zoti xh.sh. në një ajet Kur'anor thotë:

"O ju të cilët besuat, agjërimi u bë obligim për ju ashtu sikurse ka qenë obligim edhe për ata që ishin para jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm".

(El-Bekare: 183).

Bazuar në këtë ajet të Kru'anit na bën të kuptojmë se jemi të obliguar të agjërojmë, përveç pos kësaj, na mundëson të kujtojmë edhe vlerën e lartë të agjëritimit, pasi që edhe popujt e mëparshëm ishin të obliguar me të. Ndërsa, duke e kuptuar agjërimin tonë si vazhdim i trajtës së popujve të mëparshëm, përveç që është një lehtësim në obligimin e tij, ndihet edhe një kënaqësi ndaj All-llahut të lartësuar i Cili nuk na ndau prej shpërblimit me të cilin i shpërbleu besimtarët e dashur edhe para nesh.

Përpos qëllimeve të shumta fisnike të agjëritimit, agjërimi ka për qëllim arritjen e përsosshmërisë shpirtërore e cila është esenciale për njeriun. Pra, qëllimi final i agjëritimit është arritja e shkallës së devotshmërisë, shkalla më e lartë e moralit njerëzor, një shkallë devotshmërie, me të cilën plotësisht ishte i pajisur vetëm i dërguari ynë s.a.v.s..

Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin kultivohet humaniteti, drejtësia dhe barazia njerëzore. Me plotë të drejtë Muhammedi a.s. gëzohej kur vinte muaji i Ramazanit, kur ai e dinte se Xhibrili a.s. do ta vizitojë më shpesh, do t'i sjellë këshilla e udhëzime të reja nga i Madhi All-llahu xh.sh. me anë të cilave do ta përsosë qytetrimin njerëzor dhe do t'u krijojë lumturinë e fatbardhësinë e jetës. Edhe ne, besimtarët e besimit Islam me entuziazëm e presim muajin e shenjtë - muajin e Ramazanit, momentin kur para një shkëlqimi zhduket errësira. Zoti xh.sh. i thotë Muhammedit a.s.:

"Mëso vetën dhe njerëzinë për shpëtim të dy jetat".

Për vlerën dhe rëndësinë e agjëritimit të këtij muaji mund të shërbehemi edhe me disa thënie të Pejgamberit a.s.

"Kush agjëron ramazanin plotësisht duke besuar dhe duke u përmirësuar (në sjellje), do t'i falen mëkatet e mëparshme".

Në një hadith tjetër thuhet: *"Kur vjen ramazani, dyert e xhenetit hapen, dyert e xhehenemit mbyllen, ndërsa djajtë (shejtanët) janë në pranga".* Duke ditur edhe atë se ramazani nuk është vetëm ndalim nga ushqimi e pijet, por edhe nga çdo e keqe tjetër dhe kjo gjithnjë në respekt ndaj të Madhit Zot. E po që se agjërimi nuk luan rol, nuk sjell veti e virtyte

të larta duke i përsëritur këshillat e Kur'anit dhe të Pejgamberit a.s., atëherë duhet të jemi të bindur se vërtet agjërimi nga ana e besimtarit nuk është marrë si mjet real dhe i sinqertë për të arritur te devotshmëria.

Muaji i Ramazanit është muaji i paqës dhe harmonisë njerëzore. Gjatë ditëve të këtij muaji, kudo, vërejmë gjallëri, lumturi, paqë, falje, të gjitha të zbritura nga i Madhi Zot xh.sh.

Është koha kur e gjithë botë islame krijon një harmoni të plotë fetare, një harmoni e cila nuk vërehet dot në muajtë tjerë. Është muaj i prosperitetit dhe ngadhnjimit. Është koha më e përshtatshme për kërkimin e faljes nga ana e Zotit xh.sh., për pendim të sinqertë tek Ai. Pejgamberi a.s. për vlerën e këtij muaji thotë: *"Sikur ta dinin robërit se çfarë vlerë ka ramazani, do të dëshironin ummeti im që tërë viti të ishte Ramazan".*

Ramazani është muaji i Kur'anit, ngase Zoti fuqiplotë e zgjodhi dhe e caktoi këtë muaji për zbritjen e Kur'anit - Kushtetutes Islame, e cila duke shtruar fakte të sakta mbi realitetin, ndihmoi njerëzimin që të dallojnë se çka është mirë e çka është keq, të dallojë të vërtetën prej asaj që është e kotë dhe gënjeshtër, dhe të dallojë dritën prej errësirës. Për këtë Zoti xh.sh. thotë:

"Muaji i Ramazanit është ai në të cilin u zbrit Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëzit dhe plot argumente të qarta për të dalluar të vërtetën nga jo e vërteta". (El-Bekare: 185).

Pra, agjërimi si obligim është rregull i hershëm dhe është më se e sigurt se dokumentet historike nuk njohin ndonjë fe, e cila nuk ka paraparë agjërimin si obligim.

Në përgjithësi Ramazani, respektivisht agjërimi i tij duhet të luajë një rol më rëndësor në jetën individuale- shoqërore të besimtarët. Duhet të shërbejë si shkollë dhe mësim për muslimanët, duhet të na i përkujtojë të gjitha ato vepra të larta që i kryente Pejgamberi a.s. dhe shokët e tij gjatë këtij muaji si: agjërimi, namazi, sadakaja, mësimi etj. Ky është një solemnitë në të cilin janë të thirrur të gjithë muslimanët, prandaj agjërimi nuk guxon të na duket rëndë, por përkundrazi duhet të krehnohemi që jemi të thirrur nga i Madhi Zot xh.sh. Në fund lus Zotin xh.sh. që Ramazani, gjegjësisht le të na jetë mjeti me anën e të cilit do t'i afrohemi Zotit xh.sh. dhe njëherit le të na jetë një shkollë shërbyese për t'u afruar shkallës së lartë të devotshmërisë.

Xhevdet Rusinovci IV

ISLAMI - SISTEM JETE DHE NEVOJË E DOMOSDOSHME PËR NJERIUN

All-llahu i Lartësuar e krijoi njeriun në formën më të përsosur dhe e pajisi atë me aftësi e veçori me të cilat e dalloi nga krijesat e tjera. Atij ia dhuroi mendjen që me të të gjykojë, të mendojë, të meditojë, ta njohë Krijuesin e tij dhe të kësaj gjithësie, prandaj, me të drejtë, ajo mund të quhet gjëja më e çmuar me të cilën All-llahu xh.sh. e nderoi njeriun. Por, edhe pse mendja e njeriut mund t'i zgjidhë shumë probleme që shfaqen në jetën e njeriut dhe t'i kuptojë ato, ajo prapëseprapë nuk mundet dhe nuk ka potencial të dijë, të njohë, dhe të përceptojë çdo gjë, sepse është relative e krijaur, e kufizuar dhe e përkohshme.

Ajo nuk kupton derisa ajo për të cilën flitet të përkufizohet në kohë dhe hapësirë d.m.th. mendja nuk mund të përceptojë dhe ta gjykojë të pakufizuarën dhe të pakufishmen.

Megjithatë nga kureshtja, intuita, interesimi dhe natyrshmëria e lindur që ta gjejë dhe ta njohë Krijuesin e vet, ai mundohet të gjejë përgjigje në shumë pyetje enigmatike, si: Prej nga kam ardhur? Cili është qëllimi i ardhjes sime në këtë botë? A mbaron jeta vetëm me vdekje? Ku do të shkojë pas vdekjes?... etj., pyetje këto që shtrohen vazhdimisht dhe kërkojnë përgjigje të saktë për të kuptuar misteret e kësaj bote.

Ku të kërkohet përgjigja? Në shkencë?

Ajo flet për materien. Ajo përpiqet që botën ta komentojë parciaisht e nuk e ka parasysh tërësinë e as nuk ka parakushte ta rrumbullaksojë përgjigjen. Ajo e studion atë që manifestohet dhe ndodh sipas ligjeve në natyrë.

Në filozofi? Esenca e saj është kërkimi i së vërtetës e jo posedimi. Ajo është prodhim i mendjes së njeriut. Filozofia s'ka fuqi e as aftësi arbitrare sepse është njerëzore, gjithmonë me mundësi të përgënjeshtrohet e të kundërshtohet me mendimin tjetër njerëzor. Në rreligjion? Ka shumë religjione. Midis tyre ka ngjashmëri dhe dallime. Secili afron përgjigje të ndryshme duke u mbështetur në burimet dhe zhvillimin e tij historik.

Duke qenë se njeriu gjithmonë përpiqet të gjejë përgjigje, ngase natyrshmëria fetare është e lindur tek ai, gjatë kërkimit të saj shpeshherë nga paftësia që të kuptojë dhe të përceptojë çdo gjë, formon botëkuptime, qëndrime e bindje të ndryshme që shpeshherë nuk përkojnë me realitetin. Prandaj, është e domosdoshme që ai të udhëzohet e të drejtohet nga dikush që është më i Fuqishëm, më i Ditur, se ai, nëpërmjet të të dërguarve të Tij, i Cili do t'ia tregojë rrugën e drejtë, drejt të kuptuarit më të gjerë dhe më global të realitetit d.m.th. udhëzimi është më se i nevojshëm.

Por disa njerëz e refuzojnë udhëzimin duke menduar se në të zotët e mendjes dhe besojnë bile edhe argumentojnë (me argumente jologjike e të paarsyeshme) se mendja e njeriut është në gjendje të kuptojë çdo gjë dhe se të kuptuarit e saj mbështetet në shqisat dhe përvojë që nuk gabojnë asnjëherë. Por ata bien në një humnerë duke pësuar një mjerim fatal. Shembulli i tyre i përngjan atij i cili e gjen vetën në një qytet të panjohur apo shkretëtirë, përpos kësaj i urren udhërrëfyesit e Atij i Cili e solli në këtë shkretëtirë për drejtimin dhe udhëzimin e tij. Mirëpo atij pas tërës kësaj nuk i intereson që të njoftohet me ata të cilët kanë ardhur për udhëzimin dhe drejtimin e tij, por përkundrazi kthehet dhe i lufton ata, kurse ata janë të qëndrueshëm ndaj mundimeve të tij.

Ai e shan (ofendon) ata, kurse ata afrohen kah ai! Cili do të ishte mendimi i të mençurve për këtë njeri? Pa dyshim se mendimi i tyre që iu është dhënë dija dhe logjika do të ishte se: atij i nevojitet që të kërkojë Atë që e ka sjellë në këtë botë të panjohur, që të dijë fshehtësinë e ardhjes së tij. Nëse i gjen udhërrëfyesit për udhëzimin e tij nevojitet që të provojë vërtetësinë e tyre, kurse ai që nuk mundohet e nuk interesohet për vetën e tij, më të drejtë do të quanim abnormal.

Andaj, pyetja mbetet ende enigmatike! Ku të kërkohet përgjigja? pa dyshim se përgjigja do të gjendet në atë fenomen a sistem, i cili e shpjegon në mënyrë të qartë, të drejtë e të tërësishme (jo parciale) realitetin dhe misteret që fshehen në të, duke mos lënë anash as anën shpirtërore e as atë materiale (ngase të njeriu janë prezentë dy komponente - materia dhe shpirti), dhe jo vetëm kaq, por ai sistem apo fenomen duhet të jetë konsekuent, jo vetëm në teori por edhe në praktikë.

Ideologjitë e ndryshme si: religjioni dhe materializmi (sepse i gjithë spektri i ideologjive, botëkuptimeve, koncepteve e traditave të ndryshme deri më sot mund të reduktohet në këto dy botëkuptime) janë konsekuentë vetëm në teori e jo edhe në praktikë, huazojnë nga njëra tjetra sepse nuk janë absolute. Materializmi nisat nga ekzistenca primare dhe e vetme e materies, kurse tjetra nga ekzistenca e vetme e shpirtit. Megjithatë, kur dihet se njeriu është i përbërë prej dy komponenteve - materies dhe shpirtit, atëherë marrja për bazë vetëm e materies apo vetëm e shpirtit shpie kah njëanshmëria e kuptimit të realitetit.

Islami është një sistem dhe fenomen i vërtetë absolut i cili nisat nga ekzistenca e njëkohshme e materies dhe shpirtit, dhe realitetin e shpjegon në mënyrë dualiste. Pasiqë

Islami përfshin një sistem shumë të gjerë i cili reflektohet në të gjitha lëmenjtë dhe aktivitetet njerëzore do të mundohemi që t'i cekim disa veçori e karakteristika që e dallojnë këtë fe nga të gjitha botëkuptimet dhe fetë tjera. Ngase pa i shpjeguar veçoritë, karakteristikat dhe parimet themelore nuk mund të kuptohet drejt, megjithatë, ne do t'i cekim vetëm disa.

Sikur që çdo sistem a fenomen edhe Islami ka parimet e tij që burojnë nga Allahu xh.sh., Krijuesi i kësaj gjithësie, pra Islami është fe hyjnore e cila parimet e veta i mbështet në fjalën e Allahut xh.sh., Kur'anin dhe sunetin-traditën e Pejgamberit Muhammedit a.s., të cilin Allahu xh.sh., e dërgoi udhërrëfyes, udhëzues e drejtues për mbarë njerëzimin. Kjo fe është hyjnore sepse buron nga Allahu i vetëm dhe mu për këtë arsye Islami është aktual në çdo vend e kohë për mbarë njerëzimin, pa marrë parasysh kombin, racën apo gjuhën, d.m.th. është universale e gjithëpërfshirëse.

Është e arsyeshme se pse All-llahu xh.sh. është burimi i saj, ngase Ai është Krijues e Drejtues i kësaj gjithësie dhe i Cili është i njoftuar me përpikëri për gjendjen dhe nevojat e krijesave të tij. Ai është i gjithëdijshëm për çdo send.

Prandaj nuk është çudi se Islami reflektohet në të gjitha porët e jetës, sepse duhet dhe është e domosdoshme që të ekzistojë një forcë që mbisundon këtë gjithësi. Ajo do të udhëzojë e drejtojë mendjen e njeriut në rrugë të drejtë, ngase mendja e njeriut shpeshherë gabon. Shpeshherë ndodh që ne ta urrejmë ndonjë send e ai të jetë i dobishëm apo ta dojmë një send e ai të jetë i dëmshëm. All-llahu xh.sh. thotë:

"... Por ju mund ta urreni ndonjë send e ai të jetë i dobishëm dhe ju mund ta doni një send e ai është i dëmshëm për ju. All-llahu e di (funksionin) e çdo sendi, e ju nuk e dini".

(El-bekaretu 216).

Më pastaj, Islami është harmonizim i materies dhe shpirtit. Ai në mënyrë të papërsishkruar e origjinale e bën drejtpeshimin në mes tyre, duke marrë parasysh se çdonjëra nga komponentet - qoftë materia apo shpirti, anojnë nga burimi i tyre duke u munduar ta mbisundojnë njeriun. Dhe për këtë arsye Islami vë një drejtpeshim ashtuqë asnjëra të anojë aq shumë nga burimi i vet duke i harmonizuar ato. D.m.th. Ai (Islami) nuk thërret posaçërisht në tesavuf (asketizëm) apo vetëm në materializëm (Që ta mbajnë vetëm anën materiale) All-llahu xh.sh. thotë:

"Thuaj: Kush i ndaloj bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu xh.sh. i krijoi për robërit e vet? Thuaj: Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në ditën e Kijametit janë të posaçëm për ta".

(El-arafë: 32).

"Dhe me atë që ta ka dhënë All-llahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lë mangu atë që të takon nga kjo botë..."

(El-Kasas: 77).

Islami thërret në monoteizëm që është thelbi kryesor i tij.

Këtë gjë na dëshmon edhe sureja *Ihlas* 1-4:

"Thuaj: All-llahu është Një. All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet për çdo gjë, as nuk ka lindur kë, as nuk është i lindur dhe askush nuk i gjason Atij".

Islami është një sistem që përfshin dhe reflektohet në të gjitha lëmenjtë e aktivitetit njerëzor. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ne ty ta shpallëm librin, sqarim për çdo send..."

(El-nahl: 89)

Nga kjo konkludojmë se Feja Islame është fe progresive, e amshueshme apo e përhershme. Mbështetet në Fjalën e All-llahut të lartësuar dhe synnetin e Pejgamberit s.a.v.s. është e përgjithshme dhe e pandryshuar.

Fahrudin err-Rrazi - një dijetar i njohur Islam thotë:

"Islami është fe e përsosur, sistem jete, i cili mbështetet në parime të përgjithshme dhe të pandryshuara, pa marrë parasysh kohën, vendin apo nivelin kulturor. Në saje të këtyre parimeve dallohet nga të gjitha besimet, bindjet, fetë, thënë kushtimisht".

Prandaj nuk ka dyshim se shumë njerëz e kanë kuptuar vërtetësinë dhe origjinalitetin e Islamit, prandaj nuk ngurojnë që ta pranojnë atë si fe, sistem jete i cili është në përputhshmëri me natyrshmërinë e njeriut.

Por megjithë origjinalitetin, amshueshmërinë apo përhershmërinë të Islamit, disa njerëz, të ndikuar nga ideologji të ndryshme, përpiqen t'ia humbin vlerën atij, ngase ata nuk e kanë kuptuar të vërtetën ose dëshirojnë ta fshehin atë.

Atyre u mungon morali dhe ndërgjegjia njerëzore.

Megjithë përpjekjet, orvatjet e ndryshme që ta njollosin Islamin e t'i japin atij ngjyrën religjioze, regresive e primitive, Islami u bën ballë, ideologjive, rrymave të tilla, sepse kjo fe është e garantuar nga All-llahu xh.sh. dhe do të jetë nën mbrojtjen e Tij. All-llahu i lartëmadhëruar thotë:

"Ata përpiqen që me gojë të tyre ta shuajnë dritën e All-llahut e All-llahu nuk do tjetër, por ta përsosë dritën e Tij, ndonse jobesimtarët e urrejnë".

(Et-tevbe: 32)

Muhamed Broja IIIb

* Fjala "Religjion" me të cilën ajo kuptohet në përfundim si fe rrjedh nga fjala latine "Religio", dhe ndryshon rrënjësisht nga fjala Ed-din, fe që përdoret dhe theksohet në Kur'an.

Religjioni kryesisht nënkuptohet si një ideologji që ka për bazë anën shpirtërore d.m.th. objekt studimi dhe hulumtimi e ka shpirtin, kurse Islami siç e cekëm dhe më parë nisët nga njëkohshmëria e ekzistimit të materies dhe shpirtit.

Feja Islame fe universale

Nuk ka dyshim se Zoti i Madhërueshëm ka dërguar shumë peygamberë gjatë kohërave të ndryshme dhe i ka dërguar urdhërat e tij me anë të të dërguarve të Tij. Libri i fundit qiellor vërteton se mesazhet e disa të dërguarve të hershem kanë qenë vetëm për disa kohe dhe vende. Mjafton t'i cekim disa shembuj të kaptinës - Hudë.

"Ne patëm dërguar edhe Nuhin te populli i vet".

(Hudë: 25).

"Edhe te (populli) Ad (dërguam) nga mesi i tyre Hudin".

(Hudë: 50)

"Edhe te (Populli) Themud e patëm dërguar njërin prej tyre".

(Hudë: 61).

Gjithashtu edhe në kaptinën "Err-Rrum", Zoti thotë:

"Ne edhe para teje, popujve të tyre u dërguam Pejgamberë".

(Err-Rrum: 47).

Shpallja e fundit e dërguar për krejt popujt e botës, duke mos marrë parasysh se a janë të bardhë, të kuq e të zi, arabë e joarabë, evropianë, e tatarë, sepse Zoti është All-llahu i të gjithë popujve të mbarë gjithësisë.

Zoti në Kur'an thotë:

"Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botave".

(El-Fatiha: 1).

Kështu, Pejgabmeri ka qenë i dërguar për të gjithë njerëzit si "mëshirë". Mesazhi i Islamit është caktuar për të gjitha qeniet njerëzore, ku thotë Zoti: "Thuaj, "O njerëz, unë për të gjithë ju jam profet i All-llahut. Pushteti i Tij është edhe në qiej edhe në tokë...".

"Thuaj (Muhamed): O ju njerëz, Unë jam i dërguar i Allahut te të gjithë ju, vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës".

(El-Arafë: 158).

Ky verset kur'anor tregon universalitetin e FE-së Islame.

Pasi që Islami është mesazh i fundit i ardhur nga Zoti i lartësuar, atëherë kjo fe është universale për të gjithë njerëzinë, e volitshme dhe e përshtatshme për çdo kohë dhe vend.

Hadithet e Pejgabmeirit tonë, Muhammedit a.s. e bëjnë më të qartë thirrjen universale të Dinit të All-llahut, ku thotë se Bilalli r.a. ka qenë fryti i parë nga Abisinia (Etiopia e sotme). Sahabiu i njohur Selman Farisiu r.a. i pari nga Persia e dikurshme. Kështu i dërguari i All-llahut, Muhammedi a.s., ka treguar se kjo shpallje e fundit është universale për çdo vend dhe kohë.

All-llahu xh.sh. nuk është "zot klanor dhe gjelozi i Izraelit", i cili popullin e vet e vendos mbi të gjithë të tjerët, pasi që u dha atyre urdhëra të përpikta dhe ndalesa të rrepta, për të ruajtur pastërtinë e racës së tyre. Kur'ani pohon se njerëzimi është i vlefshëm pa dallim race, ngjyre apo origjine.

Qëndrimi i Islamit ndaj barabarësisë nuk mund të krahasohet me asnjë legjislacion fetar apo sekular. Të gjithë njerëzit janë të njëjtë para ligjit, kështu Feja jonë na mëson.

Në këtë drejtim thotë Zoti:

"O ju njerëz, vërtet ne ju krijuam juve prej një mashkulli e një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershëm ndër ju është ai që është ruajtur më tepër nga të këqijat e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë".

(Huxhuratë: 13).

Në këtë citat të Kur'anit të famëlartë kuptojmë se Zoti iu është drejtuar të gjithë njerëzimit, e jo një fisi apo një nacionaliteti, sipas origjinës së parë të tyre - Ademi dhe Hava. Të gjithë ata popuj që pretendojnë se ne jemi popull më superioritet në bazë të racës, ngjyrës apo gjuhës, le ta dinë se të gjithë origjinën e kanë te një babë dhe një nënë.

Islami është i pastër prej gojëdhënave se vetëm nacionalizmi është bazë e civilizimit. Profeti i saj e ka sulmuar principin tradicional të sistemit klasor se para Zotit të gjithë janë të njëjtë.

Me të vërtetë Islami është armik i diskriminimit racor. All-llahu të gjitha punët që i ka urdhëruar besimtrëit t'i praktikojnë, janë sinjale të barazisë dhe unitetit të njerëzimit. Me këto rite praktike fetare, Islami e zhvlerëson nacionalizmin në tërësi duke mos njohur diskriminim racor. Pra, shtyllat e Fesë sonë të shenjtë janë pasqyrë për barazinë e popujve të botës:

Namazi është kushti i dytë i Islamit. Sipas Islamit dyert e xhamive janë të hapura për të gjithë muslimanët duke mos shiquar në fytyrat e tyre se a janë të zi, të verdhë e të bardhë. Duke mos bërë dallime racore, shoqërore, profesionale apo më mirë të themi besimtari nuk përcaktohet në Islam në bazë të pasurisë ose prejardhjes fisnike. Nuk ka në Islam vend sistemi klasor sikur është prezent të krishterizmi. Atje, nëpër kisha, ndalohet të adhruojë krishtri zezak në kishën e të bardhëve e dallime të tjera që i përkasin krishterizmit.

Haxhi është fuqia më e madhe që i bashkon njerëzit brenda një viti. Besimtarët e vizitojnë vendin e tyre të shenjtë, Qabenë e madhëruar një herë në jetë, që bashkon vëllezërit besimtarë ndërmjet veti. Të gjithë janë të njëjtë si në veshje ashtu edhe në gjeste. Në atë vend të shenjtë, ku tubohen muslimanët e mbarë rruzullit tokësorë, që i qajnë hallet e njëri tjetrit si p.sh.. shqiptari musliman takohet me vëllaun e vet musliman që jeton në ujëdhësat më të largëta të Detit të Malajes e kështu me radhë.

Islami është Program i All-llahut, i zbritur për kushtetutë të njerëzimit, duke i plotësuar nevojat njerëzore përgjithmonë, deri në ditën e kataklizmës.

Më të vërtetë All-llahu i takojnë falënderimet dhe lavdërimet e pakufishme.

E punoi: Fatmir Latifaj kl. IV.

Agjërimi i muajit të bekuar - Ramazanit -

Agjërimi i Ramazanit është një ndër detyrat kryesore Islame, i cili është obligim fetar për çdo musliman dhe muslimane që janë moshërritur dhe psiqikisht e fizikisht të shëndoshë në kohëzgjatje prej një muaj ditësh në vit.

All-llahu i madhërueshëm në Kur'an thotë:

"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm"

(El-Bekare, 183).

Nëpërmjet këtij ajeti Zoti xh.sh. përveç që na e bën të ditur se jemi të obliguar të agjërojmë, na mundëson të kujtojmë edhe mbi vlerën e lartë të agjërit, pasi që edhe popujt e mëparshëm ishin të obliguar me të, gjegjësisht agjërimi nuk është obligim vetëm për ymmetin e Muhammedit a.s. por paska qenë obligim edhe për ymetet tjera para shpalljes së fundit.

Në këtë ajet dhe në ajetet tjera të cilët flasin për agjërimin tregohet se agjërimi nuk është paraparë në të njëjtën formë dhe në të njëjtën mënyrë, siç është paraparë për muslimanët dhe besimtarët e mëparshëm. Feja Islame agjërimin e ka bërë edukatë dhe vetëngadhnjim, si rast ideal, rrugë unike dhe shprehje e manifestimit të përkushtueshmërisë së jashtëzakonshme, vetëmohimit dhe vetëngadhnjimit, maturisë dhe vazhdimësisë - modestisë dhe bujarisë, pendimit dhe përmirësimit, pastërtisë së shpirtit, përkushtueshmërisë së Kur'anit, dhe të përkujtuarit mbi All-llahun xh.sh..

Agjërimi nuk është vetëm ndalje prej ushqimit, por edhe nga çdo e keqe tjetër dhe kjo gjithnjë në shenjë respekti ndaj Zotit xh.sh. Nëse agjërimi nuk luan rol, nuk sjell dobi, veti dhe virtyte të larta duke i përsëritur këshillat e Kur'anit dhe të Muhammedit a.s., atëherë duhet ta dimë dhe të jemi të bundiur se e meta nuk është në diç tjetër, por e meta është e jona, të cilët nuk i respektojmë urdhërat e All-llahut. E sa i përket atyre që nuk i respektojnë urdhërat e All-llahut xh.sh. gjatë agjërit të tyre i dërguari i Zotit thotë:

"Kush nuk ndalet nga fjalët dhe veprat e këqija, ai nuk ka arritur asgjë tjetër nga agjërimi, vetëm se ka vuajtur nga uria dhe etja". (Transmeton: Buhariu, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu).

Pra siç kuptohet nga ky hadith, agjërimi duhet t'i shërbejë njeriut si kështjella luftëtarit. Kur është duke agjëruar të mos flasë fjalë të këqija, të mos bëhet injorant, por nëse dikush e fyen Muhammedi a.s. thotë: Thuaj: "Unë jam duke agjëruar" (Transmeton: Buhariu)

Siç shihet nga e tërë kjo Zoti xh.sh. dëshiron që përmes agjërit të arrihet shkalla e devotshmërisë (takvallëkut) për të cilin virtyt flasin shumë ajete kur'anore dhe hadithe të Muhammedit a.s., virtyt ky të cilin "mjerisht" pak muslimanë e posedojnë.

Shpërblimi i All-llahut për agjërimin

Pasi që All-llahu xh.sh., për çdo vepër të mirë shpërblen edhe për agjërimin All-llahu do të shpërblejë meqë edhe ky

bën pjesë në grupin e veprave të mira. Lidhur me këtë Pejgamberi a.s., thotë:

"Në prag e kemi muajin e Ramazanit, muajin e bereqetit, në të cilin muaj Zoti do t'ju përfshijë me mëshirën e Tij, na i fal gabimet, na i pranon lutjet, na shikon sa jemi dhënë pas hajrit, na lavdëron te melaiket. Pra paraqitni dhe tregoni punë të mira, sepse nuk ka dëshprim më të madh nëse njeriu nuk përfshihet nga kjo mëshirë e Zotit".

Ndërsa në një hadith tjetër thotë:

"Çdo punë e njeriut i përket atij, përveç agjërit. Ai është i Imi dhe për atë Unë shpërbelj". Pra siç kuptohet nga ky hadith All-llahu përveç që shpërblen për agjërimin, Ai ka një shpërblim të posaçëm siç u cek në hadithin e lartëshënuar. Kurse All-llahu xh.sh., thotë:

"Dhe kur t'ju pyesin robërit e Mi për Mua, Unë jam me të vërtetë afër, i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet".

(El-Bekare, 186).

Disa hadithe për agjërimin

- Kur të vijë muaji i Ramazanit do të hapen dyert e xheneteve dhe do të mbyllen dyert e xhehenemeve dhe do të pengohen shejtanat.

- Sikur ta dinin robërit e Mi se çfarë vlere ka Ramazani, do të dëshironin që tërë viti të ishte Ramazan.

- Në muajin e Ramazanit ymmetit tim i janë dhënë pesë gjëra, që nuk i janë dhënë ndonjë pejgamberi tjetër (para meje) e ato janë:

1. Kur vjen nata e parë e Ramazanit Zoti xh.sh., shiqon me shqim të Vet dhe nuk i denon ata (Ymmetin).

2. Melaiket luten për faljen e tij ditë e natë.

3. All-llahu xh.sh., urdhëron xhenetin e i thotë: "Zbukurohu për robin Tim agjëruës, sepse do të pushojë nga lodhja e kësaj bote (ai do të pushojë) në shtëpinë Time".

4. Me të vërtetë aroma e gotave të tyre kur të bëjnë iftar është më e këndshme se aroma e miskut.

5. Kur të vijë nata e fundit, All-llahu xh.sh., i fal të gjithë, nga se punëtorët punojnë dhe kur ndahen nga puna (Kur e kryejnë punën) e marrin shpërblimin e tyre.

- Agjërimi është gjysma e sabrit (Durimit), kurse durimi është gjysma e imanit (Besimit).

- Ai që agjëron edhe agjërimin e ka ibadet.

- Agjëruesi i ka dy gëzime: një në iftar, por jo pse han, por pse arrin të jetë i vendosur në vendimin e tij, dhe tjetrin kur e takon All-llahun xh.sh., në botën tjetër.

- Pasha Atë, që shpirti im është në duart e Tij, era e gojës së agjëruesit është më e këndshme se All-llahu se sa era e parfumit, (Agjëruesi) e lë ushqimin, pijen dhe kënaqësinë (thotë All-llahu) për Mua është i Imi dhe Unë për të shpërblej dhe për secilin vepër të mirë do të ketë shpërblim të dhjetëfishtë.

Gazmend Mehmeti Kl. IIIa

NAMAZI - KUSHT I DYTË PËR TË QENË MUSLIMAN

Në kohën e fundit po hasim në "besimtarë" të cilët nuk e praktikojnë faljen e namazit. Andaj si duhet të sillemi me personin i cili nuk e praktikon namazin?

Namazi është obligim i dytë pas dëshmisë se nuk ka Zot tjetër pos All-llahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij. Mos nënshtrimi ndaj All-llahut konsiderohet si tradhti e detyrës më kryesore të një muslimani dhe për këtë shkak individit nuk meriton të quhet musliman e as të mbrohet nën hijen e Islamit.

Këtë mendim e perforcojnë edhe më tepër këto fjalë të shenjta dhe të besueshme të Muhamedit s.a.v.s.:

"Mes besimtarit dhe mosbesimtarit është lënia e namazit".

"Ajo me çka dallohem me ta (mosbesimtarët) është namazi, pra kush e lëshon namazin, është mosbesimtar".

Ata që e lëshojnë namazin, e bëjnë për dy shkaqe:

1. Për shkak se e mohojnë se namazi është obligim dhe nuk i kushtojnë kurrfarë rëndësie atij. Të tillët, sipas mendimit unanimit të dijetarëve Islamë, trajtohen si mosbesimtarë.

Pra ai njeri që mohon dhe përgënjeshtron urdhërin e Zotit dhe të dërguarit të tij, trajtohet si mosbesimtarë. Për këtë lloj të njerëzve, All-llahu xh.sh., thotë:

"Atij që kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij i takon zjarri i xhehenemit, aty mbetet përgjithmonë"

(En-Xhin: 23).

Ky ajet mjaft mirë përshkruan pozitën e atyre që e mohojnë namazin.

2. Nuk falen nga përtacia, duke shkuar pas epsheve të veta dhe mashtrimeve të shejtanit. Rreth kësaj dijetarët Islamë thonë:

a) Ebu Hanife r.a., thotë:

Përsoni i tillë do të konsiderohet si mëkatar dhe do të jetë e domosdoshme që të rrahët derisa t'i rrjedhë gjaku e mandej të izolohet derisa t'ia fillojë të falet.

b) Imam Maliku dhe Shafiu (rahmetullahi alejhuma) thonë:

Njeriu i tillë është mëkatar, ai nuk konsiderohet si mosbesimtar, por edhe dënimi me rrahje nuk mjafton madje as izolimi, e në qoftë se është kryefortë në mendimin e tij duhet të dënohet me vdekje.

c) Ahmedi ibni Hambeli r.a., thotë:

Përsoni i tillë është mosbesimtar dhe renegat. Ai do të dënohet me vdekje, por para kësaj do të kërkohet nga ai që të pendohet te Zoti dhe të falë namazin. Nëse pranon këtë

kusht do të lirohet, nëse jo, atëherë do të dënohet me vdekje. Është e ditur se mendimi i këtyre dijetarëve është i mbështetur në Kur'an dhe sunnet.

Në Kur'an theksohet edhe rasti, i cili tregon gjendjen e mosbesimtarëve në ditën e kijametit, ku thuhet:

"Atë ditë mjer përgënjeshtarët! Se kur u thuhej përu-luni, nuk përuleshin. A të mjer përgënjeshtarët!"

(Murselat: 47, 48).

Gjithashtu përshkruhet dialogu në mes të besimtarëve dhe mosbesimtarëve në ditën e gjykimit, kështu thuhet në Kur'an:

"(Besimtarët do të pyesin) Ç'ju solli në Sekar? (Mosbesimtarët) do të thonë ne nuk e kryenim namazin, nuk ushqenim të varfërit dhe përziheshim me të tjerët në punë të kota, ndërsa ditën e gjykimit nuk e besonin derisa erdhi vdekja!"

(Mudethir: 42, 43).

Pra gëja e parë që do të shpjerë njerin në zjarr është mospërfillja e namazit.

Sani Avdiu nx. IV

DËSHIRA IME

Edhe këtë dëshirë
arrita ta plotësoj,
në shkollën "Alaud-din"
mësimin ta vijoj.

Shumë të gëzuar
mëngjesi më zgjon
shpejt përgatitëm
për asgjë s'mrzitëm.

Për këtë rrugë të drejtë
shumë herë kam menduar
Zotin; dhe urdhërin e Tij
çdoherë duhet zbatuar.

Shqipe Begolli kl.1.

NAMAZI LARGON PREJ TË KËQIJAVE

"Dhe fale namazin"! Me siguri namazi largon prej amoralitetit dhe prej punës së shëmtuar. Por të përkujtuarit Zotit është gjëja më e madhe. Zoti di për atë që bëni ju."

(Ankebutë: 45)

Për efektin që e bën namazi te ai i cili e zbaton me vëmendje e kujdesje, nuk mbetet të dyshohet pas kësaj thënie të lartë të Madhit Zot xh.sh.. Edhe Pejgamberi a.s. për namazin ka thënë: "Namazi është shtylla e dinit. Kush e zbaton ashtu si kërkohet, e ka mëkëmbur e fuqizuar dinin, e kush nuk e fal, ai e ka rrënuar dinin".

Edhe pse këtë rol të namazit e ka vërtetuar praktika, nuk është tepër të studiojmë edhe një herë fshehtësinë e këtij efekti e të vërtetojmë edhe në bazë të logjikës, megjithëqë, kjo nuk do të thotë se do të shtojmë diç më tepër në besimin tonë. Sipas Kur'anit namazi është mjet për të larguar njeriun prej punëve të pamoralshme dhe të pakëndshme, e me këtë shpëtojmë të ndershëm në të dy jetat.

Së pari këtu duhet t'ia vejme veshin fjalës "Ekim" në Kur'an edhe fjalës "Ekam", në hadithin e pejgamberit a.s. e cila na jep të kuptojmë se fjala është për faljen e namazit me kujdes dhe vëmendje. Namazi nuk falet shkel e shko sa për t'u shkarkuar prej obligimeve. Mes namazit të falur, sipas mënyres së parë dhe të dytës ekziston një ndryshim shumë i madh. E mu për këtë qëndron shkak sipas mendimit tonë, sepse në fund të ajetit në fjalë thuhet "Zoti e di për atë që beni ju". Ai i di të gjitha, qofshin ato konkrete ose sekrete, e di për namazin që e falni ju, e di se e keni falur ashtu sikurse edhe kërkohet me vëmendje e maturi ose e keni falur vetëm sa për ta kryer një detyrë.

Besimtari, pra, nuk është i obliguar me namaz, me këtë detyrë të lartë e të përditshme në jetën e tij, vetëm që ky namaz të shërbejë si mjet pastrimi i ndërgjegjes së tij. Zaten, nëse i shikojmë me një sy kritik detyrat dhe obligimet që parasheh Feja Islame, do të vërtetojmë se ato përmbajnë në vete disiplinë, rregull dhe pastërti prej çfarëdo lloji ndytësie.

Sheriati Islam, i cili namazin e konsideron lidhje të shkallës më të lartë në mes të njeriut dhe Zotit, për arsye se namazi përmban lutje, përkujtim, respekt, mbështetje dhe rikthim të Zotit xh.sh., bëri kusht pastrimin e përgjithshëm për këtë detyrë të lartë.

Njeriu mund të hyjë në namaz me tekbinin fillestar, vetëm pasi që të jetë i pastërt në trup, petka e vend. Madje, për të qenë ky pastrim gjithnjë prezent, sheriati Islam e ka lidhur këtë me shumë shkaqe të cilat përseriten shpesh në jetën e njeriut, bie fjala: abdestin për namaz, larjen e tërë trupit pas xhunubllëkut, pas menstruacioneve. Larja e tërë trupit, petkun e vendit prej ndytësirave etj. Ky pastrim është i jashtëm (fizik), pra i dukshëm dhe konkret.

Gjithashtu edhe mjetet e këtij pastrimi janë fizik, si uji për abdest e larje dhe dheu për tejemum, në mungesë të ujit. Dijetarët Islamë (FUKAHATË) shkoqitën në detaje rregullat rreth këtij pastrimi dhe hartuan literaturë mjaft të gjerë lidhur me këtë fushë. Mirëpo, namazi, sikur që e kuptojmë edhe prej ajetit, ka për detyrë të luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Ky pastrim i brendshëm apo shpirtëror është i fshehtë, është sekret në thellësinë e të cilit s'është në gjendje askush të depërtojë përveç Zotit, se edhe mjetet e tij, sikurse është për qëllim vendosja (nijjeti) pendimi dhe kthimi i singertë.

Kur ndalemi dhe vështorojmë me vëmendje të plotë rëndësinë e njeirut dhe tjetrit pastrim, sigurisht do të vërejmë se ky i dyti, i brendshmi është më i rëndësishëm, e cila është e vetmja peshojë për vlerësimin e veprave.

Ky është i kushtëzuar me qëllim e nijjet të pastër dhe të singertë. E nijjeti është bazë për të qenë vepra e vlefshme dhe e pranueshme te ZOTI i Lartësuar. Ky (obligim)j kërkon që vepra të kryhet për hir të Zotit xh.sh. e kurrësi të mos e shoqërojë atë vepër ndonjë formalitet a demagogji. Ky bën që të dallohet vepra e vërtetë, reale dhe vlefshme prej atyre që nuk përmbajnë gjë tejër vetëmse lëvizje gjuhësore dhe trupore, të cilat edhe janë gjykuar në një ajet të kaptinës "MAUNË" ku Zoti xh.sh. ua tërheq vërejtjen formalistëve duke iu thënë: "Të mjerët ata namazli, të cilët e harrojnë përkujtimin". Pra, njeriu (besimtari) kur falet, jo me vëmendje e me një precizitet, atëherë, All-llahu do të dënojë për moskujdesin ndaj namazit.

Mbetet parim i pakontestueshëm se namazi largon prej të këqijave dhe edukon njeriun në sjellje të lartë dhe moral të pastër. All-llahu ua mundësoftë besimtarëve të VET, që obligimet t'i kryejnë me përpikëri shumë të madhe.

SHKËLZEN SALIHU KL. II-b

ZEKATI OBLIGIM MORAL

Muhammedi a.s. popullin e tij e gjeti të prapambetur në çdo aspekt. Arabët e pasur silleshin keq me të varfërit, të vobektit, bonjakët etj. Islami këto dukuri të këqija i çrrënjosi. Muhamedi a.s. në fillim u urdhërua që njerëzit t'i thërrasë në besim në Zotin një, pastaj u urdhërua edhe në zbatimin e rregullave fetare, si namazi, agjërimi, zekati, haxhi.

Një ndër obligimet fetare është edhe zekati.

Zekati në Kur'an dhe hadith përmendet shumë. All-llahu xh.sh. thotë:

Dhe faleni namazin dhe jepni zekatin"

(El Bekare: 10)

Në bazë të këtij ajeti zekati është farzi ajn-për çdo njeri të moshës madhore dhe arrin sasinë e caktuar.

Muslimani me kryerjen e këtij obligimi arrin kënaqësinë e All-llahut xh.sh. dhe shpërblimin e tij. Zekati është formë e ndieshmërisë së përgjegjësisë shoqërore e cila përmbush zemrën e muslimanit, si dhe ndjenjë e fortë e solidaritetit dhe lidhshmërisë. I Dërguari i Zotit thotë: "Sadaka është ajo që merret nga të pasurit dhe i jipet të varfërit." Të ndërtuarit e shoqërisë duhet të qëndrojnë në solidaritet dhe ndihmesë reciproke ashtuqë pasuria të mos qarkullojë nëpër duart e të pasurve dhe të varfërit të mos jenë të privuar nga nevojat elementare për jetë. Pasuria i takon All-llahut xh.sh. dhe gjithë njerëzit janë pjesëmarrës në të, nëse jo të barabartë bile në atë masë e cila i mundëson të varfërit të bartin peshën e jetës dhe u ndihmon të luftojnë me nevojat e kësaj bote.

Ai i cili e jep zekatin pastron pasurinë e tij, paraqet ngritjen shpirtërore dhe shërimin nga koprracia. E All-llahu xh.sh. thotë:

"Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që t'i pastrosh me të dhe t'u shtosh (të mirat)"

(Et Tevbe: 103)

Islami zgjedh obligimin e solidaritet shoqëror ashtuqë zekatin e bën një nga kushtet e tij, e nëse kryen me zemër, ajo është shenjë që imani është bërë pjesë e pandashme e qenies së tij.

Pasi që zekati është një nga themelet e islamit atëherë mohimi i tij të dërgon në humnerë. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: "A e ke parë ti atë që përgënjeshtrohet për-

gjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër? Po, ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë bonjakun. Dhe që nuk nxit për të ushqyer të varfërin."

(El Maunë: 3)

Nga ky ajet nxjerrim se ai i cili e mohon zekatin, ai ka mohuar botën e ardhme dhe ringjalljen pas vdekjes.

Muslimani e di se zekati është zgjedhje e sukseshme dhe humane e problemit të skamjes, dobësisë dhe prapambeturisë në ballafaqim me jetën. Zekati është burim i cili derdhet në grykën e varfërisë, grykë e cila lehtëson dhembjet, afron dallimet.

Dëshmitar i kësaj ka qenë historia e shoqërisë islame, sepse këta kanë respektuar këtë rregull islam. Shoqëritë islame kanë qenë të mbrojtura nga skamja dhe varfëria. Zekati i ofronte ata të cilët kishin dhe nuk kishin dhe i zbuste dallimet në mes të njerëzve.

Ai është zgjidhje e tillë që zvoglon urrejtjen e zbut ashpërsinë e përleshjes dhe udhëheq solidaritetin në mes të pasurve dhe të varfërve. Me anë të zekatit shoqëria islam ka arritur të vendosë qetësinë mes të shtresave të ndryshme dhe t'i lidhë me lidhjen e ndjenjes reciproke dhe drejton baraspeshën, solidaritetin dhe shërimin e shumë problemeve të cilat kërcnohen në shoqëri.

Prandaj muslimani nuk e rrudh dorën kur janë në pyetje të drejtat e shoqërisë. Ai nuk i ekspozohet rrezikut, sepse e di se egoizmi nuk do t'i sjellë të mira as në këtë botë e as në të ardhmen.

Muhamed a.s. ka thënë: "Nuk ka ditë në të cilën njerëzit gëdhihen e të mos zbresin dy melaiket nga e cila njëra thotë: O Zot, shpërbleje atë që ndan e tjetra thotë: Zot shkatërroje atë që nuk ndan."

E All-llahu jep bekimin dhe bereqetin në pasuri dhe atë ua kompezon. All-llahu thotë:

"E çka do që të jepni, Ai e kompezon atë dhe Ai është Dhuruesi më i madh".

(Sebeë: 39)

Sead Morina III-b

KUR'ANI LIBËR HYJNOR E JO VEPËR NJERËZORE

Falënderimi dhe lavdërimi i takon All-llahut xh.sh.. Krijuesit të çdo gjëje. Atë e falënderojmë dhe prej TIJ ndihmë e falje kërkojmë. Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi Muhammedin a.s. mbi shokët e tij, mbi familjen dhe mbi të gjithë pasuesit e rrugës së tij deri në ditën e gjykimit.

Kur'ani është një libër udhëzues dhe mëshirë për mbarë njerëzinë. Mrekullia e tij është e përsosur për të gjitha kohët. Në kohën e fundit mrekullia e tij po dëshmohej edhe më shumë nëpërmes të arriturave shkencore. Mirëpo, edhe pse ky libër është mrekulli, disa njerëz nuk duan të besojnë.

Këtë gjë njerëzit e bëjnë se ndoshta nuk kanë njohuri për Kur'anin, por shumica e këtij lloji të njerëzve mundohen që me anë të teorive të tyre të thata dhe të paargumentuara fare ta zhvelrësojnë vlerën dhe madhërinë e këtij libri. Ata nuk zgjedhin metoda dhe mënyra që ta fyejnë Kur'anin, duke thënë edhe këtë: "Se Kur'ani është vepër njerëzore". Këtë e bëjnë vetëm nga injoranca dhe urrejtja që kanë ndaj këtij libri të pastër, Andaj do të mundohem nëpërmes këtij shkrimi, në pika të shkrutara, ta jap një vështrim kritik mbi ata që mendojnë se autor i Kur'anit është vetë Muhammedi a.s.

Sa i përket burimit të Kur'anit, studiuesit ndahen në tri grupe kryesore:

a) Ata që e besojnë se Kur'ani nuk ka autor njerëzor, por është shpallur fjalë për fjalë nga All-llahu xh.sh..

b) Ata që mendojnë se Muhammedi a.s. është autor i Kur'anit.

c) Ata që mendojnë se Muhammedi a.s. nuk ishte autori i Kur'anit, por atë e mësoi nga një njeri ose nga grup njerëzish.

Andaj shtrohet pyetja: Kush është autor i Kur'anit?

Kësaj pyetje do të mundohem t'i përgjigjem duke përdorur disa fakte logjike, dëshmi historike, të dhëna shkencore si dhe fakte nga vetë burimi.

Që në fëllim do të paraqesim disa nga mendimet e pabesimtarëve mbi burimin e Kur'anit. Keneth në librin e tij "THIRRJA E MINARES" THOTË: "Teksti i Kur'anit bazohet mbi traditën gojore, por Muhammedi ia atribuoi Perëndisë duke dashur ta shpëtojë popullin e vet nga krimi i adhurimeve të idhujve".

Pra, sipas tij, Kur'ani është shprehje e Muhammedit a.s.. Disa të tjerë mendojnë se Muhammedi a.s. shkroi me qëllim të përfitimit material, të tjerët thonë se qëllimi i shkrimit të Kur'anit nga ana e Muhammedit ishte dëshira e tij për pushtet dhe lavdi. E ka edhe prej tyre që mendojnë se

Muhammedi ka përfituar njohuri nga doktrinat hebreje dhe krishtere dhe ka arritur që ta përpilojë një Kur'an të tillë.

Të gjitha këto thënie janë të pabesimtarëve që mundohen ta njëjlojnë të Vërtetën, por e vërteta nuk mposhtet. Është e arsyeshme që t'i përmendim disa argumente dhe ta sqarojmë se a është e vërtetë ajo që thonë ata?!

Thënia e K. Kregit: "Se Muhammedi e hartoi Kur'anin"?, bie ndesh me realitetin. Këtë Kur'ani e mohon duke thënë:

"Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili) Në zemrën tënde për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtje" (Esh-Shura)

"Ai ta zbret ty (MUHAMMED) librin me argumente që është vërtetues i librave të mëparshme. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin" - Një gjë të tillë All-llahu e shpreh realitetin edhe në vende të tjera në Kur'anin e TIJ, si në kaptinat en-Nisa, Nahl... Mandej në Kur'an, folja "KUL" përmendet shumë herë. Nga kjo shihet se Kur'ani mohon autorsinë e tij. Mirëpo, përveç që e mohon këtë gjë, ai na jep edhe mënyrën se si t'i bindim ata që mendojnë të kundërtën. All-llahu në Kur'an thotë:

"E nëse jeni në dyshim në atë që NE ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju një kaptinë të ngjashme me të".

(Suretul-bekaretu: 23)

Mandej dihet fare mirë se Muhammedi a.s. ishte njeri pa shkollë. Një gjë të tillë e cek edhe Kur'ani: "Ti (Muhammed) nuk ishe që lexon ndonjë libër para tij e as që e shkruante atë (Kur'anin) me dorën tënde të djathtë, atëherë pse po dyshojnë ata të prishurit". (Ankebut: 48)

Andaj shtrohet pyetja: a mund ta shkruajë një libër të pakrahasueshëm njeri analfabet? Andaj është e ditur se Kur'ani zbriti që t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë.

Ta sqarojmë pikën tjetër se gjëja Muhammedi a.s. e ka përpiluar Kur'anin për të përfituar pasuri. Kjo e thënë është pa bazë që nuk përputhet me realitetin historik. Gjendja ekonomike e Muhammedit a.s. ishte e mirë, apo më mirë të them shumë më e mirë para se të bëhet Pejgamber. Në moshën 25 vjeçare (15 vjet pa i ardhur shpallja) u martua me Hatixhën e cila ishte një ndër gratë më të pasura në vendlindjen e tij. Mirëpo pas ardhjes së Shpalljes dhe stolisja e tij me Pejgmaber për tërë njerëzimin dhe tërë kohën, gjendja e tij në aspektin ekonomik pësoi ndryshime totale.

Në përmbledhjet e hadithit shënohet transmetimi i Aishes r.a. që tregon se zjarri në shtëpinë e tyre nuk ndezej një deri në dy muaj, sepse nuk kishte për çka. I vetmi ushqim i Pejgamberit a.s. ishte qumshti i dhisë, hurmet dhe uji.

Omeri r.a. duke na përshkruar dhomën e Pejgamberit a.s. Thotë: "Një ditë hyra te i dërguari a.s. dhe prej asaj që pashë ishin tri lëkura të thara bagëtie dhe një grusht elb i hedhur në një skaj të dhomës. Atëherë Muhammedi a.s. më tha: "Pse po qanë"? Unë iu përgjigja: E si të mos qaj o i dërguari i All-llahut kur të shoh se në çfarë gjendje ndodhesh. Lute Allahun që të na jep ushqim të bollshëm. Si ka mundësi që persianët dhe romakët që nuk e adhurojnë All-llahun xh.sh., por i adhurojnë mbretërit e tyre, të jetojnë në kopshte të lulëzuara e në shadravane të pastr, kurse ti të jetosh në varfëri".

Omeri r.a. tregon se Muhammedi a.s. ishte mbështetur në jastëk kur dëgjoi këto fjalë, u ngrit dhe tha: O Omer, a ende vazhdon të dyshosh për këtë. Qetësia dhe rehatia në botën tjetër janë shumë më të mira se sa çdo e mirë në këtë botë. Kafirat po i shijojnë shumë të mira në këtë botë, kurse në atë botën e ardhme nuk do t'i shijojnë, kurse të gjitha të mirat për botën e ardhme janë të përgatitura për muslimanët". Atëherë Omeri thotë se i kërkonte falje".


Dikush e pyeti Aishen r.a. për shtratin e Muhammedit a.s. se si ishte, ajo tha: "Ai ishte prej lëkure dhe i mbushur me gjethe të palmes". Pra, kjo ndodhte kur Muhammedi a.s. po të donte mund të jetonte sikur mbretërit tjerë. Kjo nuk ishte një sakrificë e përkohshme, por ishte një mënyrë e të jetuarit.

Pika tjetër të cilën e përdorin armiqtë e Islamit është se gjëja Muhammedi a.s. e shkroi Kur'anin me qëllim të dëshirës për pushtet dhe lavdi.

Nëse e shiqojmë jetën e Pejgamberit a.s., do të shohim se ai nuk ishte i etur për pushtet e as për lavdi personale. Dëshira për lavdi shpeshherë gjen shprehjen e saj në banesat e mrekullueshme, në rrobat e shtrenjta e në kënaqësitë tjera me radhë, kurse Muhammedi a.s. nuk ishte i tillë. Ai edhe pse ishte burrështeti angazhohej edhe në punët e shtëpisë, i milte dhitë dhe kryente çdo punë tjetër të shtëpisë. Ai fliste me çdo individ që dëshironte të flasë me të. Ai gjithashtu ishte i butë gjatë bisedave dhe nuk e hidhëronte asnjëherë askënd. Mandej erdhi një kohë kur shokët e tij filluan të ngriten në këmbë në shenjë respekti ndaj tij, por ai e ndaloi atë duke thënë: "Mos u ngritni në këmbë siç ngriten persianët për mbretërit e tyre". Pejgamberi a.s. u ndihmonte shokëve të tij në çdo punë që e bënin, nuk dëshironte të dallohej nga të tjerët. Ai shpeshherë konsullohej me shokët e tij dhe e respektonte mendimin e të tjerëve, siç ndodhi në Luftën e Bedrit, Uhudit etj. Ai gjithashtu ndaloi që varri i tij të shndërrohej në vend adhurimi. Po ta kishte shkruar në Kur'anin Muhammedi a.s. me dëshirë për pushtet dhe lavdi, së pari do të anulonte ato ajete që binin ndesh me ambicjet e tij, por ai nuk e bëri këtë.

Sikur Muhammedi a.s. ta kishte shkruar Kur'anin për pushtet dhe lavdi nuk do t'iu thoshte njerëzve se unë jam i pafuqishëm dhe nuk di asgjë tjetër përveç asaj që më shpallet prej All-llahut xh.sh., pastaj të thoshte se Kur'ani nuk është fjalë e tij.

Muhammedi a.s. sikur ta kishte qëllimin për pushtet dhe lavdi, do t'i pranonte ato gjëra që ia propozuan prijësit e



Mekkes duke i thënë se çdo të mirë në këtë botë të japim vetëm që të largohesh nga kjo, por ai këtë nuk e pranoi.

Të shqyrtojmë pikën që pason se kinse Muhammedi a.s. shkroi Kur'anin me qëllim që t'i bashkojë fiset arabe dhe lirinë e tyre. Duhet ta dimë qartë se në Kur'an asnjë ajet nuk flet mbi bashkimin dhe lirinë e arabëve në mënyrë të veçantë. Në të nuk mund të gjejmë asnjë ajet që thërret "O popull arab", por All-llahu xh.sh. na thërret me fjalën "O JU NJERËZ", pastaj "O besimtarë", d.m.th. se këto i thërret All-llahu të gjithë njerëzit në përgjithësi pa dallim kombi, race etj.

Sikur të kishte për qëllim Pejgamberi a.s. bashkimin e arabëve nuk do të pranonte në Fenë Islame njerëz nga hebrejtë, krishterët etj. Sikur të ishte për qëllim bashkimi i popullit arab, nuk do të përmendej Merjemja, e cila nuk ishte nga populli arab, por ishte nga beni Israilët. Pra, ky nder që i bëhet Merjemes, nënës së Isaut a.s. në Kur'an, nuk e bën as Bibla si libër i shenjtë i krishterëve. Kur'ani nuk e përmendi nënën e Muhammedi apo ndonjë grua tjetër arabe.

Disa të tjerë mendojnë se Muhammedi a.s. ka marrë njohuri nga doktrinat krishtere dhe hebreje. Këta nuk kanë kurrfarë argumente që t'i marrin si të vërteta. Athua si mundi Muhammedi a.s. ta marrë nga ata, kur e dimë fare mirë se ai nuk dinte shkrim-leximin. E dyta është se Muhammedi a.s. ende pa i ardhur shpallja është takuar vetëm dy herë me pjesëtarët e feve të tjera edhe atë njëherë në moshën gjashtë vjeçare. Si mundi që t'i mësojnë 66 apo 73 libra të Bibles brenda dy herësh dhe në moshë aq të vogël. Pra, këto dy takime ndodhen në një kohë shumë të shkurtër.

Në Kur'an gjenden ajetet që kanë të bëjnë me argumentet shkencore që për atë kohë ishin të panjohura, të cilat argumente bota bashkëkohore sot po i vërteton me anë të teknikës. Athua si mundi t'i dijë Muhammedi a.s. këto ajete në mënyrë aq të artë dhe aq precize. Nga të gjitha këto argumente që i cekëm gjer më tani na flasin qartë se nuk është burimi Kur'ani të vet njeriu, por ky është një mrekulli i zbritur nga All-llahu xh.sh. dhe burimi i saj është Vet All-llahu xh.sh.

Këto ishin vetëm disa argumente që flasin kundër autorësisë njerëzore të Kur'anit të marra nga libri "Burimet e Kur'anit" nga autori Hamza Mustafa Njazi.

Lusim All-llahun e Lartësuar, që të na bëjë prej atyre që ta besojë këtë libër me një besim të sigurtë dhe të na bëjnë prej atyre që e zbatojnë këtë libër në praktikë.

Shaban Murati, klasa e IV

KUR'ANI

*KUR'ANI është libër i shenjtë,
që udhëzon njerëzit në rrugë të drejtë,
që udhëzon njerëzit në rrugën e shpëtimit,
dhe largimin nga idhuj-adhurimi.*

*KUR'ANI është libër hyjnor,
që i zbriti Pejgamberit tonë,
që me leximin e tij,
Zotin xh.sh., e adhurojmë*

*KUR'ANI është libër i zbritur,
që na sjell dobi,
dhe ia mësoi njeriut,
atë që se kishte ditur.*

*KUR'ANI është libër i drejtë,
që urdhëron në drejtësi,
dhe kërkon nga njeriu,
që t'i kryejë urdhërat e tij.*

*Sepse Pejgamberi i jonë i fundit Muhammedi
a.s.,*

*me këtë gjë ishte i porositur,
që t'i thërrasë njerëzit për besim në Zotin një,
dhe largimi nga idhuj-adhurimi*

Punoi: Bedri Syla Kl.II-b

BESIMI I PASTËR

Falënderimi dhe lavdërimi i takon vetëm All-llahut s.v.t. Paqa Mëshira shpëtimi qoftë mbi pejgamberin a.s. Mbi familjen e tij të pster mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë sunnetin e tij deri në ditën e gjykimit.

Islami, prej ditës që është shpallur, ka qenë i luftuar nga kurejshitet, persianët, bizantinët, tatarët, krishterët etj. Mirëpo All-llahu u ndihmoi muslimanëve të ngadhënjejnë mbi ta. Kurse armiqtë e islamit nuk pushuan duke përgatitur gracka, kurtha të ndryshme kundër Islamit. Pasi që nuk patën mundësi ta shkaktrojnë islamin haptazi. Ata gjeten forma të reja se si ta luftojnë atë (Islamin). Duke themeluar sekte të ndryshme në emër të Islamit, duke shpikur bidate (risi) të ndryshme, duke inicuar ibadetin në varreza, teqe, tyrbe. Ata gjithashtu kanë bërë vende të posaçme për tavaf (për tu sjellë) rreth tyre, kanë shpikur lutje të posaçme me të cilën u drejtuan atyre. Mirëpo islami është i pastër dhe larg tyre. Për fat të keq këto sëmundje të rrezikshme të përgatitura nga armiqtë e Islamit i ka përfshirë anekënd trojet e banuara me muslimanë.

Këto janë bërë shkak që muslimanët të shmangen nga ibadeti të cilin duhet bërë vetëm para All-llahut s.v.t. Duke kërkuar ndihmë prej varrezave të njerëzve të mirë. Andaj njerëzit e padishëm veprojnë në këtë mënyrë, duke menduar se kjo është një pjesë përbërëse e fesë dhe mënyra më e mirë e afrimit tek All-llahu, mirëpo këto parime janë në kundërshtim me Islamin. Për t'u bërë të qartë muslimanëve se këto bidate (risi) që u përmenden më lart nuk kanë të bëjnë me Islamin, ata duhet të njihen me tewhidin (besimin) e pastër që e kanë pasur të gjithë të Dërguarit e All-llahut s.v.t. Këtë tewhid (besim) e ka pasur edhe i dërguari i fundit Muhammedi a.s. sahabët (shokët) e tij dhe do të kenë ata që i pasojnë këta deri në ditën e gjykimit.

TEWHIDI ULUHIJJE

Tewhidi i të Adhuruarit . - është veçimi i All-llahut s.v.t. me të gjitha llojet e adhurimit, si me lutje, kurban, besatim, namaz, mbështetje, frikë, shpresë, në të kërkuarit ndihmë etj. Me këtë tewhid kanë predikuar të gjithë të dërguarit e All-llahut xh.sh. te popujt e vet që t'i udhëzojnë kah adhurimi i All-llahut s.v.t.

Mirëpo këtë lloj të tewhidit e kanë mohuar kafirët (mo-tiesit), dhe ky ka qenë shkak kryesor i armiqësisë ndërmjet

pejgamberëve dhe popujve të tyre. Duke filluar prej Nuhit e deri te Muhammedi a.s.v.s. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ne patëm dërguar edhe Nuhin të populli vet (me porosi të njëjtë si Muhammedin t'u thotë): Unë ju tërheq vërejtjen haptazi që të mos adhuroni tjetër kë pos All-llahut, sepse unë kam frikë për dënimin tuaj në ditën e pikëllueshme".

(Hud 25-26).

Poashtu edhe për Hudin

"Edhe tek (populli) Adi (Derguam) nga mesi i tyre Hudin që tha: o popull, adhuroni All-llahun, ju vetëm po hutoheni me trillime".

(Hud, 50).

Musa a.s. duke polemizuar me Faraonin, dëgjoi nga ai edhe këto fjalë "E cili është Ai Zoti i botave (që, ju dërgoi)" Musa a.s. u përgjigj "Zoti i qiejve dhe i tokës dhe çka ndërmjet tyre, nëse bindeni".

Ndërsa Isa a.s. iu drejtua popullit të tij me këto fjalë "All-llahu është Zoti im dhe Zoti i juaj adhurone Atë, kjo është rrugë e drejtë".

Dhe në fund All-llahu i drejtohet pejgamberit të fundit, Muhammedit a.s. me porosinë e Tij që ky t'u drejtohet Ehlu-kitabive (Ithëtarve të librit)

"Thuaj (O i Derguar): O ithtarë të librit, të bashkohemi te një fjalë që është e njëjtë (drejtë) mes nesh e mes jush. Të mos adhurojmë pos All-llahut, te mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njeri tjetrin zot pos All-llahun".

(Ali-Imran, 64).

Në bazë të ajeteve që u ceken më lartë na bëhet e qartë se të gjithë të dërguarit e All-llahut xh.sh. janë dërguar që të thërrasin njerëzit të besojnë All-llahun s.v.t. të adhurojnë Atë, dhe të mos i shoqërojnë Atij asnjë send. Siç thotë All-llahu:

"Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'iu thotë Adhuroni vetëm All-llahun e largohuni djajve (idhujve).

TEWHIDI RUBABIJJE

Tewhidi i Zotit. - është bindje e prerë se All-llahu është Zot i çdo sendi, Sundues, Krijues, Përcaktues i tij. Nuk ka shok në sundim, nuk ka refuzim të urdhërit të Tij, nuk ka të ngjashëm e as ndërrim të vendimit të Tij. Tewhidi Rububijje është shprehje e cila nënkupton njesimin e All-llahut s.v.t. në tri çështje:

- 1) Krijim
- 2) Sundim
- 3) Përcaktim

1) Argumente se All-llahu është Krijues ka shumë, por argumenti më i mirë është vetë fjala e Tij, ku All-llahu në Kur'an thotë:

"Vërtet Zoti juaj është All-llahu, i cili krijoi qiejt e tokën brenda 6 ditësh pastaj qëndroi mbi Arsh".

(Junus, 3).

A mos u krijuan prej kurgjës apo ata janë krijues të vetvetës"

(Tur, 35).

"O ju njerëz, ja një shembull, veni veshin pra: vërtet ata që po i adhuron në vend të All-llahut ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të, e po ashtu nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk do të mund të shpëtojnë atë prej saj".

2) Sundimi i njeriut është i mëngët ndërsa sundimi i All-llahut është i plotë.

"Edhe dielli edhe hëna e edhe yjëti i janë të nënshtuar sundimit të Tij".

"Sundimi i qiejve dhe i tokës është vetëm i All-llahut e ditën kur ndodh kijameti, atë ditë mohuesit dëshprohen"

3) All-llahu është përcaktues i çdo sendi.

"A (faraoni) deshi të dejojë ata nga vendi (Egjipti), kurse ne i përmbysem atë dhe të gjithë ata që ishin me të së bashku. Pas tij Beni Israilve u thamë: Rrini në vend e kur të vijë koha e botës tjetër. ne iu sjellim të gjithëve të përzier"

(El-Isra, 23-24).

Këtë Tewhid e kanë pranuar edhe idhujtarët, kurejshitet mirëpo kjo gjë nuk i ka futur në Islam ngase All-llahu xh.sh. thotë:

"Nëse ti i pyet ata: kush i krijoi qiejt e tokën? me siguri do të thonë: Ato i krijoi i Gjithëfuqishmi i Dishmi".

(Zuhruf, 9).

Me këtë kuptojmë se idhujtarët e pranojnë se All-llahu xh.sh. është Zot, Krijues, mirëpo i përshkruajnë ndërmjetësues për të arritur tek Ai (All-llahu). Kurse All-llahu s.v.t.i. dëshmon fjalët e mushrikëve në Kur'an ku thotë:

"...ne nuk adhurojmë atë për tjetër vetëm që të na afrojnë sa më afër All-llahut".

(Zumer, 3)

ESMAUN WE SIFATUN

Tewhidi i emrave dhe i cilësive është besim apo bindje në atë me të cilën e ka cilësua All-llahu s.v.t. vetën në Kur'an dhe me atë me të cilën e ka cilësuar i dërguari i tij

Muhammedi a.s. prej emrave të bukur të All-llahut xh.sh. apo cilësive të Tij të larta.

Besimtarët janë të obliguar të besojnë me bindje të plotë ajetet e Kur'anit dhe hadithet e pejgamberit a.s. të cilët vërtetojnë cilësitë dhe emrat e bukur të Tij.

Po i cekim disa prej cilësive të All-llahut xh.sh.

- HAJAT - All-llahu s.v.t. jeton me jetën e Tij të amshueshme siç thotë në Kur'an:

"All-llahu është Një dhe nuk ka të adhurar pos Tij, është i përjetshëm, Mbikqyrës"

(Ali-Imran, 2).

- ILM - All-llahu shtë i Gjithëdijshëm...

"All-llahu është Ai që e di çka ka në qiej e në tokë dhe All-llahu është i Dishëm për çdo send"

(Huxhurat, 16).

- IRADET - All-llahu s.v.t. ka dëshirën e Tij absolute.

"Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm bëhu Ai menjëherë bëhet"

(Jasin, 82).

- KUDRET - All-llahu është i Gjithëfuqishëm.

"All-llahu ka fuqi për çdo gjë".

(Feth, 21).

- SEM dhe BESAR All-llahu dëgjon dhe sheh gjithçka.

"All-llahu dëgjon dhe sheh (gjithçka)".

(Nisa, 134).

- KELAM - All-llahu flet me të folurit e Tij special.

"All-llahu Musait i foli me fjalë".

(Nisa, 164).

- RAHMET - All-llahu është i Gjithëmëshirshëm.

"Mëshira ime ka përfshirë secilin send."

(Araf, 156).

Më parë përmendëm se All-llahu s.v.t. në mes tjerash ka edhe cilësi SEM - BESAR, po ashtu edhe njeriu ka këto cilësi "andaj e bëmë të dëgjojë dhe të shohë..." (Ali-Imran, 2) por të dëgjuarit dhe të pamurit e njeriut nuk mund të krahasohet me cilësitë e All-llahut s.v.t. ngase cilësitë e Atij janë të plota kurse cilësitë e njeriut janë të mëngëta. Besimtarët besojnë në të gjitha emrat dhe cilësitë e All-llahut s.v.t. të cilën e ka cilësuar apo emëruar All-llahu qenien e tij të lartë në librin e Tij, apo me të cilën e ka cilësuar apo emëruar krijesa më e ditur për të Muhammedi a.s.v.s. duke mos pyetur si, duke mos ndërruar kuptimin e drejtë të cilësisë apo emrit, duke mos përgjasuar me krijesat dhe duke mos i mohuar këto.

Agron Terziqi III

MORALI ISLAM

Për të folur për moralin Islam domosdo duhet marrë shembull të dërguarin e All-llahut s.av.s. i cili posedonte një moral shumë të lartë. Ai ishte shembull për të tjerët dhe i pakrahasueshëm në çdo aspekt. Pra, sa i përket njeriut, gjegjësisht besimtarit, çdo veprim dhe lëvizje e tij duhet përshtatur me punën dhe veprën e Pejgamberit a.s. Në këtë gjendje ishte i dërguari i All-llahut xh.sh., ku vetë Kur'ani na njofton decidivisht:

"Vërtet ti (Muhammed) je në një shkallë të lartë të moralit".

(El-kalem: 4).

Ndërsa i dërguari islam thotë: "Jam i dërguari për përsosjen e virtyteve të moralit".

Kur'ani na vërteton se jeta e Pejgamberit a.s. nuk kishte asgjë tjetër, vetëm se shfaqja e parimeve të moralit të lartë. Ai ishte i udhëhequr prej mësimave të Kur'anit, të cilat i zbatonte vazhdimisht në jetën e tij të përditshme. Prandaj Kur'ani i porosit muslimanët që, nëse dëshirojnë lumturi në të dy jetat, atë duhet kërkuar nga jeta e të dërguarit të tyre.

Virtytet e moralit të tij, të cilat duhet të jenë shembull dhe prezente te të gjithë ne, ishin shprehje e porosive të larta të Zotit xh.sh. Për këtë thotë i Madhi All-llah në Kur'an:

"Ty (Muhammed) nuk të kemi dërguar për tjetër vetëm se mëshirë për mbarë njerëzimin".

(El-Enbija: 107).

Kjo thënie e lartë e të madhit Zot për qëllimin e misionit, të cilin dërgohet Muhammedi a.s. na jep të kuptojmë se fatbardhësia më e madhe për botën njerëzore është paraqitja në skenë se si ishte krijesa më e vlefshme dhe më e zgjedhur ndër të gjitha krijesat e kësaj ekzistence.

Prandaj, sjellja e njeriut, edukata dhe morali i tij janë pjesë përbërëse të jetës së njeriut. Ato shërbejnë si baza mjaft me rëndësi për formimin e personalitetit të tij në Islam. Njeriun, Zoti xh.sh. e ka lënë të lirë në zgjedhjen e rrugës së kësaj jete, prandaj njeriut i është mundësuar të jetë kontrolues e dirigjues i sjelljeve dhe veprimeve të tij, e të ndalohej nga veprat të pahishme dhe amorale, të cilat nuk përkojnë me parimet e shenjta të Islamit, të cilat shpiejnë kah shakëterrimi dhe degjenerimi individual e - shoqërore.

Prandaj ne si besimtarë duhet të jemi ata të cilët duhet të veprojmë ashtu siç na ka urdhëruar Zoti xh.sh. në Kur'an, ashtu siç na ka porositur Pejgamberi a.s. në fjalët e tij dhe shprehjet e tij të frymëzuara nga Kur'ani dhe njehërit shërbejnë si shembull në mesin ku jetojmë e punojmë. Me fjalë të tjera "MORALI ISLAM" duhet të jetë bazë, themel mbi të cilën duhet të ndërtohet jeta reale e besimtarit (njeriut).

Se sa të larta ishin mësimet e Muhammedit a.s. na argumenton fakti se asnjë pejgamber nuk e gjeti popullin e vet në një shkallë më të ultë, në pikëpamje etike (të moralit), se sa që e gjeti pejgamberi ynë popullin e tij, pra popullin arab. Megjithatë, në saje të mësimave të drejta, ai arriti suksesin më të madh, ngase atë popull të zhytur në injorancë, sketerrë e amoralitet, arriti ta shpëtojë duke e larguar, prej bestytive e veseve dhe në vend të tyre të kultivojë (vendojë) besim të qartë e të sinqertë në Njësinë e Zotit dhe mroal fisnik e të lartë, Zoti xh.sh. thotë:

"Vërtet ju kenë shembullin më të bukur (të mirë) në të dërguarin e Zotit..."

(El-Ahzab, 21).

Me të vërtetë kjo thënie na obligon të gjithëve që të trasojmë rrugën e të dashurit të Zotit, njeriut më fisnik dhe më moral më të lartë. Ky është morali islam, me këtë duhet të pajisemi të gjithë, të dimë se vetëm të pajisur në këtë mënyrë do të arrijmë lumturinë në të dy botat. Është më se e nevojshme të përmendim (të cekim) edhe atë se edhe rininë tonë, popullin tonë në përgjithësi e ka katandisur një rënie tepër e ultë e moralit. Prandaj për të dalë nga kjo krizë e rëndë morale duhet t'i përvishemi punës e të veprojmë në përputhshmëri të plotë me atë çka urdhërojnë Kur'ani dhe synneti, sepse vetëm të harmonizuar me këto "dy gjëra" do t'ia arrijmë qëllimeve tona. Për këtë Zoti xh.sh.: thotë "Me të vërtetë All-llahu nuk do të ndryshojë gjendjen e një populli, përderisa ai popull mos të ndryshojë vetën".

Në fund të kësaj që u tha e lusim All-llahun xh.sh. që të na ndihmojë dhe të na pajisë me moral të lartë Islam, ashtu sikur që e pajisi të dashurin e Tij, Muhammedin a.s. shembulltyrën më të ndritshme të moralit Islam.

Xhevdet Rusinovci IV

PASTËRTIA DHE MBROJTJA E SHËNDETIT

Feja Islame i ka kushtuar rëndësi të madhe si edukimit shpirtëror ashtu edhe atij trupor. Në bazë të principeve të saj, jemi të detyruar që të ruajmë shpirtin nga mëkatet - gjynahet, kurse trupin nga ndytësitë e ndryshme. Pastërtia është një ndër kushtet kryesore për mbrojtjen e shëndetit.

Islami i kushton rëndësi të madhe ruajtjes së shëndetit dhe besimtari kërkon përgjegjësi për mosruajtjen e tij, ngase është një dhunti e çmueshme prej All-llahut xh.sh.. Shëndeti është i lidhur ngushtë me pastërtinë. Po të mungojë pastërtia nuk do të kemi as shëndet të mirë.

All-llahu xh.sh., në lidhje me këtë thotë:

"Vërtet All-llahu xh.sh., i do ata që pendohen, dhe i do ata që janë të pastër, (ruhen prej punëve të ndyta e të neveritshme)".

(El-Bekare 222).

Sikur vepra e ligë që pastrohet me pendim të sinqertë ashtu edhe ndytësira nga trupi largohet me pastërti e larje. Prej mënyrave të pastrimit fetar kemi pastrimin e përgjithshëm, në rast nevojë, pastrimi i obligueshëm, pas marrëdhënieve intime, pastrimin e preferuar së paku një herë në javë, e sidomos ditën e xhuma. Muhammedi a.s. thotë:

"Pastërtia është pjesa e Imanit".

Deshti Zoti i Madhëruar që në fenë tonë të pastër, pastërtinë ta bëjë pjesë të besimit, gjë që flet më së miri mbi rëndësinë e pastërtisë dhe ruajtjes së shëndetit. All-llahu xh.sh. na ka obliguar që disa namaze t'i bëjmë në xhami dhe në kohë të caktuar. Kur shkojmë në xhami për t'u falur, për hir të All-llahut xh.sh. duhet të shkojmë të pastër.

All-llahu xh.sh. thotë:

"O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje)..."

(El-Arafë: 31).

Siç shihet nga ky ajet, ai i cili bën namaz e shkon në xhami, duhet të shkojë me pastërti trupore dhe rroba të pastërta.

Çdo musliman dhe muslimane janë të obliguar për t'i falur pesë kohët e namazit brenda 24 orëve. Ndër kushtet kryesore, pa të cilat nuk mund të hyhet në namaz, janë abdesi, pastrimi i trupit, teshat dhe vendin ku falemi. Zoti xh.sh. me këtë na ka urdhëruar duke thënë:

"O ju besimtarë, kur të çoheni për ta falur namazin, lani fytyrat dhe duart me gjithë bërryla, jepni mes-h kresë dhe lani këmbët me gjithë nyje, nëse nuk jeni të pastër, pastrohuni mirë (krejt Trupin)".

Pastaj Muhammedi a.s. thotë:

"Kur të vijë dikush prej jush në namazin e xhumasë le të pastrohet"

"Pastrimi në ditën e xhumasë është vaxhib për çdo moshëritur".

Muhammedi a.s. higjenës i ka kushtuar kujdes të posaçëm, ai përveç që ka qenë shembull, me shumë hadithe

ka këshilluar se si duhet të mbahet pastërtia. Në mes tjerash Muhammedi a.s. na thotë:

"Principet fetare në lidhje me pastrimin janë dhjetë:

1. Prerja dhe rregullimi i mustaqeve
2. Lëshuarja e mjekrrës.
3. Përdorimi i brushës për t'i pastruar dhëmbët.
4. Bëria synet.
5. Pastrimi i hundëve deri në brendësi.
6. Prerja rregullisht e thonjve të duarve dhe të këmbëve.
7. Pastrimi mirë në mes gishtave dhe nyjet e tyre.
8. Pastrimi i nënsqetullave.
9. Heqja e qimeve në vendet e turpshme.
10. Pastrimi me ujë mbas kryerjes së nevojës.

Muhammedi a.s. ka mbajtur mjekërr, ku njëkohësisht është interesuar për mirëmbajtjen e saj. Mustaqet i ka prerë rregullisht dhe nuk ka lejuar që t'i kalojnë buzën e epërme, kurse mjekrrën e linte sa e kap me grusht, tepicën e ka shkurtuar.

Feja Islame bëries synnet i ka kushtuar rëndësi të madhe. Ky akt në përgjithësi ka karakter higjenik dhe është shumë i dobishëm për mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga sëmundjet e ndryshme.

Pastrimi i dhëmbëve e ka një rëndësi të madhe për shëndetin e njeriut, për shkak se mbeturinat e ushqimit mund të formohen mikroba të ndryshme, të cilat i shkatërrojnë dhëmbët dhe mund të sjellin pasoja të tjera të dëmshme. Në lidhje me këtë Pejgamberi a.s. thotë:

"Sikur mos të kisha frikën se po e ngarkojë shumë ummetin tim, kisha për ta urdhëruar t'i pastrojnë dhëmbët me brushë (misvak) para çdo namazi". (Transmeton Tirmidhiu).

Si në punë e si për nevoja tjera njeriu më së tepërmi shërbehet me anë të duarve, prandaj mund të infektohemi me anë të tyre, sidomos me rastin e përdorimit të ushqimit. Për këtë Muhammedi a.s. na ka urdhëruar për t'i larë duart para buke dhe pas buke. Me pastrimin e duarve nënkuptojmë edhe prerjen e thonjve. Mosprerja shkakton formimin e mikrobeve.

Përveç pastërtisë trupore feja Islame na ka urdhëruar që t'i mbajmë të pastëra dhe teshat. All-llahu na ka urdhëruar, duke na thënë "Teshat tuaja" pastroji "Muhammedi a.s. në veshmbathie ka qenë modest, i rregulluar dhe i pastër.

Teshat duhet t'i ruajmë sidomos me derdhjen e ujit, për shkak se Muhammedi a.s. na ka thënë: "Ruane me rastin e derdhjes së ujit se shumica e dënimit të varrit rrjedh prej saj".

Kur kihet parasysh ajetet dhe hadithet që i përmendem më lart mund të konkludojmë se vërtet Islami është i pastër dhe i do ata që janë të pastër.

GAZMEND HALIMI IIIa.

SINQERITETI DHE RRENA

All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat! ta keni në kujtesë All-llahun dhe të jeni me ata të drejtë!"

(Et-tewbe: 119)

- Detyrë primare e të gjitha shpalljeve hyjnore ka qenë, pos udhëzimit të njerëzve në besim të drejtë, ta përsosin moralin njerëzor, të cilit Islamizmi i ka kushtuar kujdes shumë të madhe, sa që Pejgamberi a.s., e vë në krye të listës mbi qëllimin e detyrimit të Tij, ku thotë:

"Jam i dërguar për përsosjen e normave-virtyeve të moralit".

- Në anën tjetër edhe Kur'an moralin e thekson si veti më të lartë të Pejgamberit a.s., ku All-llahu xh.sh. thotë:

"Vërtetë ti je në një shkallë më të lartë të moralit".

(El-kalem: 4)

Njëra ndër vërtetësi më kryesore të moralit është sinqeriteti, për të cilën do të bëjmë fjalë në vazhdim. Zoti xh.sh., i ka dhënë vend evident në një numër ajetesh në Kur'an. Të shumta janë edhe hadithet e Pejgamberit a.s., që shtjellojnë këtë temë. Kjo dëshmon se kemi të bëjmë me një çështje serioze dhe me rëndësi në jetën e njeriut. Krijuesi i gjithësisë në Kur'an, në ajetin e 70 të sures El-Ahzab, urdhëron:

"O ju besimtarë, përmbajuni mësimëve të All-llahut dhe thoni fjalë të drejta".

(El-Ahzabë: 70)

Pastaj në ajetin tjetër thotë:

"Ai (All-llahu) ju mundëson të bëni vepra të mira, ju shlyen juve mëkatet tuaja..."

(El Ahzabë: 71)

All-llahu xh.sh. në këto ajete, së pari na porosit për devotshmëri, sepse vetëm ai që i frikësohet All-llahut në vepra dhe adhurime, do të jetë i sinqertë ndaj Tij. I tilli atëherë mund, dhe patjetër duhet, të jetë i sinqertë edhe në veprimet e tij me njerëzit. Për këtë, së pari, na urdhëron në devotshmëri e menjëherë pas saj në sinqeritet e vërtetësi. Në Kur'an ka shumë ajete të ngjashme me këtë, gjë që është peshojë e mirë për rëndësinë e vërtetësisë.

All-llahu xh.sh. thotë:

"Ata të cilët respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij, do të gjenden me ata të cilët i ka begatuar Perëndia prej profetëve, të dërguarve, të vërtetëve, shëhidëve dhe njerëzve të mirë. Sa shokë të mirë janë ata!"

Në këtë ajet vihet në pah se vërtetësia nuk është vetëm në fjalë, por edhe në vepra, në qëllime, vendime, në mbajtjen e premtimit etj. Andaj personat që janë të vërtetë në këto, All-llahu xh.sh. i radhit mbi shëhidët e njerëzit e mirë, menjëherë pas pejgamberëve! Mirëpo, pa dyshim, më kryesore prej këtyre është vërtetësia në fe, e cila qëndron në sinqeritetin e njeriut, në shpresë dhe frikë, kënaqësi e besim,

në dashuri ndaj All-llahut dhe të dërguarit të Tij, vërtetësi në punë. Kjo do të thotë në punë të mos ketë përzierje të shirkut e as të hipokrizisë!

Sa është e lavdëruar vërtetësia shihet edhe nga fakti se All-llahu të Dërguarin e Tij e quan "SIDDIK" - të vërtetë. Kështu p.sh. në këtë ajet për Ibrahimin a.s. thuhet:

"Përkujtoje në libër (Kur'an) Ibrahimin. Vërtet ai ishte i vërtetë në fjalë dhe ishte i dërguar i All-llahut xh.sh.".

Edhe për Ismailin a.s. në Kur'anin famëlartë thuhet:

"Përkujtoje në Kur'an Ismailin, i cili ishte i vërtetë në premtim dhe ishte i dërguar"

All-llahu xh.sh. dhe i dërguari i Tij vërtetësisë ia japin këtë epitet dhe apelojnë për të, jo pa qëllim, por për të na mbrojtur neve nga pasojat e rënda që rrjedhin nga ajo që është në kundërshtim me të, e që vetvetiu na imponohet t'ia kushtojë disa fjalë. Ajo është rrena.

E tani të shohim se çka është rrena?

Nga praktika e jetës së përditshme, çdonjeri prej nesh e di se rrena çka është. Pra, ajo është se nëse me qëllim e flasim atë që nuk i përgjigjet të vërtetës dhe realitetit. Rrena, jo vetëm që është e dëmshme, por, është edhe veti e turpshme, e urrejtur dhe vetëm si e tillë trajtohet në Kur'an, në fjalët e Pejgamberit a.s., e edhe thënie e urta të popullit e qortojnë këtë dukuri negative me përmasa shoqërore. Kjo është prej veprave më të këqija. Kur them këtë, gjithësesi e kam parasysh këtë hadith të Muhammedit a.s.

Ky hadith qëndron në veprën e njohur "El-ihjau"

"Transmetohet se një njeri kishte ardhur te Pejgamberi a.s. dhe i thotë: Jam i dhënë në tri vepra të ndaluara dhe nuk po mundem të frenohem, ato janë: prostitucioni-zinaja, rrena dhe pirja alkoolike. Pejgamberi a.s. i tha: rrenën lëre për mua! Pastaj shkoi. Filloi të mendojë në vete për të bërë zina, tha, nëse bëj, pastaj më pyet Pejgamberi a ke bërë. Nëse i them po! Do të më ekzekutohet dënimi! Kështu e braktisi zinanë. Pastaj filloi të mendojë për të pirë alkool, mirëpo edhe këtu i solli të njejtat paragjykime dhe e braktisi edhe atë...

- Nga ky rast kuptojmë se rrena qenka burimi i të gjitha të këqijave, andaj dhe më së tepërmi prej veseve e ka urrejtur Pejgamberi dhe shokët e tij. Për këtë pra urdhëroi për braktisjen e saj e jo të dy tjerave, e me atë rast ai arriti që t'i ndalojë edhe ato dyja nëpërmjet saj.

- Pasojat e rrenës janë të rënda, e shpesh mund të jenë tragjike e bile katastrofike, si për atë që rren ashtu edhe për atë që e dëgjon. Nga kjo arsye Alejhisselami rrenacakët i vë në radhën e munafikëve, të cilëve All-llahu xh.sh., në Kur'an u premtonte këtë dënim.

All-llahu xh.sh., thotë:

"Për arsye se kanë rrejtur për ta do të ketë dënim të dhimbshëm..."

- Pejgamberi a.s., për të na ruajtur neve nga këto dënime, e nga ana tjetër për të na lehtësuar t'i njohim vetitë e hipokritëve e të ruhemi prej tyre, thotë:

"Te ai që ndodhen katër cilësi është hipokrit: 1. Kur flet-gënjen, 2. Kur i besohet-tradhton, 3. Kur premtom-mashtorn dhe 4. Kur e tepron në ngatërresa".

- Pa mëdyshje rrena më e rëndë dhe mëkati i saj më i madh që mund ta shkaktojë njeriu, natyrisht, është rrena ndaj Krijuesit, siç e vërteton edhe Kur'ani:

"E kush është më zullumçar se ai që shpif rrenë All-llahut (duke ia përshkruar një gjë që nuk e ka".

- Pastaj vjen rrena mbi të dërguarin e All-llahut, e ai vetë ka thënë: "Kush rren për mua diçka me qëllim, le ta përgatisë një karrigë prej zjarrit (në xhehenem)".

- E këtë nga arsyeja se Alejhisselami ishte predikues, i rregullave fetare, i shpalljes, andaj edhe rrena për të është njëherit edhe rrena në All-llahun xh.sh., sepse fjalët e Pejgamberit për fenë ishin vetë shpallja.

- Kjo gjë i ka shtyrë shkencëtarët e hadithit që të jenë shumë rigorozë dhe nuk i pranonin hadithet që i transmetonin personat e dyshimtë, apo ata të cilët akuzoheshin për rrenë, po edhe në qoftë se rrena është qëllimmirë.

- Pastaj vjen rrena ndaj kujtdo qoftë prej njerëzimit dhe në çfarëdo mënyrë qoftë e shprehur. Kjo është e qortuar dhe rreptësisht e ndaluar-haram, ndërsa ata që e shkaktojnë i mbjellin vetes urrejtjen e All-llahut. Atyre u mohohet besimi (i plotë) siç u mohohet edhe shpëtimi atyre që e përdorin. Këtë e thotë Kur'ani në këtë ajet:

"Në All-llahun rrejnë vetëm ata të cilët nuk besojnë në argumentet e Tij dhe ata janë rrenacakë të vërtetë".

(Nahl: 105)

- Muslimani duhet t'i largohet rrenës, po edhe nëse sheh në të dëmin personal, sepse në të ka shpëtim prej shkatërrimit ngase vetë ajo është shkatërrim. U cek se rrenacakët do të vuajnë dënimin, do të jenë të poshtëruar në ditën e gjykimit, mirëpo ata edhe në këtë botë janë të urrejtur, të përbuzur e të pabesuar, sa që as dëshmia e tyre nuk u pranohet.

- Andaj prej të gjithë neve ishtarë të Kur'anit e të Sunetit, kërkohet që sa më ashpër e me vendosshmëri të luftojmë e njëherit t'ua shpejgojmë peshën e vërtetë të saj atyre që kanë nevojë e që nuk e dinë sa duhet.

- Për këtë, padyshim kemi, nevojë për ndihmën e All-llahut fuqiplotë, andaj i lutemi që të na ndihmojë për ta trasuar rrugën të cilën na e trasoi Pejgamberi a.s., atë rrugë të ndiçuar me dritën e Kur'anit, dhe me sukses t'i kalojmë pengesat e ndryshme të cilat dalin në rrugë e në krye të të cilave me siguri është rrena.

Arsim Ademi kl. II-b

KËSHILLAT E REDAKSISË

I

*Me plot ndjenja të zjarrita
vargjet i radhiti
mos shpifni për të tjerët shokë
thotë: Fatmir Latifi.*

II

*Pastaj Driton Morina
këshillat i vazhdoi
kush i gënjen të tjerët
xhehenemit s'mund t'i shpëtojë*

III

*Shaban Murati
vërtet ka treguar
kush e pi alkoolin
vetën e ka shkatërruar*

IV

*Ilir Osmani
e ka thënë të vërtetën
kush e beson All-llahun
e ka shpëtuar vetvetën*

V

*Agron Terziqi
të gjithë i ka këshillaur
kush e beson All-llahun
rrugën e Pejgamberit
duhet pësuar.*

Driton Morina kl. IV.

Kushtuar këshillit të redaksisë "DRITA E KUR'ANIT".

LLUKMAN HAKEMI E KËSHILLON TË BIRIN

All-llahu xh.sh. thotë:

"Ne, me të vërtetë, i kemi dhënë Llukmanit mençuri"

Suretu Llukman: 12.

Prindërit janë shkolla më e lartë që mësojnë fëmijët që të jenë të dëgjueshëm ndaj normave të shenjtë islame: Kur'anin dhe sunnetin. Këshilla prindërore duhet të zërvend të fëmijët e besimtarëve. Familja është një institucion në të cilin fëmija pajiset me njohuri të para në mënyrë të përgjithësuar ndaj asaj që e rrethon. Ajo, poashtu, është institucion i parë edukativ. Këshillat e familjes, me të cilat pasurohet fëmija duhet të jenë të harmonizuara me Kur'an dhe sunnet, sepse vetëm në këtë mënyrë arrihet një edukim dhe një pasqyrim i drejtë i moralit tek fëmija.

All-llahu xh.sh. si shembull të kujdesit prindëror ndaj fëmijës përmend këshillat e Llukmanit a.s. drejtuar të birit të tij, të cilat edhe neve mund të na shërbejnë si model. Nga ato shohim tërë atë çka dhe si duhet udhëzuar fëmijët tanë dhe çfarë këshillash duhet dhënë atyre. Ja disa këshilla të Llukmanit a.s. të përmendura në Kur'an:

"Përkujto popullin tënd) kur Llukmani, duke e këshilluar të birin, tha: O djali im, mos i përshkruaj All-llahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe..."

(Llukman: 13)

"O djali im, fale namazin, urdhëroi për punë të mira e ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet këto janë nga çështjet më të preferuara".

(Llukman: 17)

"Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se All-llahu nuk e do asnjë mendjemadh dhe që shumë lavdërohet".

(Llukman: 18)

"Të jesh i matur në ecjen tënde, ule zërin tënd, se zëri më i egër është zëri i gomarit"

(Llukman: 19)

Dijetari dhe historiani Islam Sa'lebiu, përveç kështilla në Kur'an përmend edhe disa këshilla tjera, disa prej tyre janë:

O biri im, bota është det i thellë dhe shumë njerëz mbyten në të. Anija jote të jetë droja ndaj Zotit, timoni, besimi në All-llahun xh.sh.

O biri im, prej botës merr vetëm aq sa ke nevojë të domosdoshme për jetë, mos i kushto kënaqësi të jetësore aq shumë sa që për shkak të saj t'i dëmtosh të tjerët e as mos u bë dembel e t'i rëndosh të tjerët. O biri im, bëhu shërbëtor i çdo pune të mirë, e biri u bërë kurrë i një të keqe.

O biri im, rri me dijetarët dhe me njerëzit e mençur. Shfrytëzoje çdo rast për të mësuar diçka prej tyre. Kur t'i pyetesh, pyeti sjellshëm e jo ashpër dhe poashtu edukueshëm se ata mund të urrejnë. Mos u bërë i mërzitshëm, se e tepron.

- Biri im, asnjë vepër apo punë mos e konsidero të vogël, sepse ajo vepër e njejtë nesër mund të jetë e rëndësishme.

Biri im, ziliqari dallohet me tri gjëra: Atë që nuk është në prezencë, e nënçmon dhe e merr nëpër gojë, të pranishmin e lavdëron dhe për të keqen e çdokujt gëzohet.

Biri im, kur dëgjon diçka të keqe, fshehe në zemrën tënde dhe askujt mos i trego, se, përndryshe, ajo mund të bëhet forcë që mund ta djegë gjuhën tënde.

Biri Im bëhu gjithmonë i gatshëm për të dëgjuar fjalë të All-llahut dhe të Pejgamberit a.s. e jo për të treguar fjalë të pahishme.

Biri im, kur të ndodhesh në namaz, ruaje zemrën tënde, kur ndodhesh në shtëpinë e huaj, ruaj sytë, kur ndodhesh ndër njerëzit, mendo çka po flet.

Biri im, Dy gjëra gjithmonë t'i kesh ndërmend: Vdekjen dhe All-llahun e lartësuar.

Biri im, dy gjëra harroi dhe asnjëherë mos u mundo t'i dish:

Të mirën që ia ke bërë dikujt dhe të keqën që ta ka bërë dikush.

Pejgamberi a.s. në një rast ka thënë: "Llukmani duke e këshilluar të birin i tha: "Biri im, shoqërohu me njerëz të ditur. Dëgjo ç'flasin njerëzit e mençur dhe të matur, se All-llahu me dritën e mençurisë e ngjall zemrën e vdekur, sikur që me ramjen e shiut ngjallet toka e vdekur.

Jemi të obliguar t'i këshillojmë fëmijët, që të jenë besimtarë të devotshëm. Të gjithë prindërit do të përgjigjen për fëmijen e tij. All-llahu i Lartmadhëruar thotë:

"O ju që keni besuar, ruane vetën dhe familjen tuaj prej zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët..."

Edhe i dërguari i All-llahut, Muhammedi a.s. thotë:

"Ju të gjithë jeni kujdestarë dhe të gjithë do të përgjegjeni për atë që ju është dhënë në ruajtje-përkujdesje". Transmeton Buhariu.

Vetëm me ndihmën e All-llahut arrihet edukimi dhe veshja me moral të pastër të fesë sonë të shenjtë, ISLAME.

Mehmet Istogu KL. II-b.

Barazia mes njerëzve

Dhuratat që Islami ia solli njerëzimit janë të shumta, e një nga ato është Uniteti dhe Barazia. Në shumë vende në Kur'an bëhet fjalë për këtë. Në këtë ajet All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju njerëz, Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë që të jetoni në bashkësi, kombe e fise ashtu që më lehtë të njiheni mes vete. Në të vërtetë më i ndershmi prej jush te Zoti është ai më i ruajturi (më i kujdesshmi). Vërtet Zoti është më i ditshmi dhe më i njohuri".

(El huxhurat 13).

Dëshmia më e madhe për Unitetin e mbarë njerëzimit, të cilin e porositi Kur'ani, duket në shprehjen e parë të këtij ajeti, ku thotë All-llahu xh.sh.:

"O ju njerëz...". Kjo është thirrje e përgjithshme, e përbashkët dhe unike për të gjithë njerëzit pa dallim, të bardhë apo të zi, të varfër apo të pasur, punëtorë i thjeshtë apo sundues i madh. Islami e ka për qëllim të çrrënjose në mënyrë të vendosur të gjitha bindjet që kanë të bëjnë me racë, komb, pasuri, pozitë etj.

Nga fillimi i ajetit të lartëpërmendur "o ju njerëz", i shprehur në fillim të ajetit, shihet shumë mirë se Kur'ani respektivisht, Zoti xh.sh. njerëzit i konsideron njësoj dhe nuk bën kurrfarë dallimi në mes tyre.

E kur thuhet: "ne u krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre...", forcon frymën e vëllazërimit, duke na bërë ta

kuptojmë se jemi të një barku, të një origjine, forcon idenë e afërsisë vëllazërore, e si të tillë jemi të obliguar të ruajmë këtë dhe të respektojmë, sepse, përndryshe, do të jemi përgjegjës para All-llahut dhe para njerëzimit.

Fryma e vëllazërimit të njerëzve, sipas Kur'anit, do të arrihet vetëm në bazë të bashkëpunimit, ashtu që të gjitha begatitë që i krijoi All-llahu në fytyrën e tokës t'i shfrytëzojmë dhe t'i përfetojmë së bashku, sepse janë të krijuara për të gjithë.

Ndarja në shtete e kontiente nuk guxon të shërbejë si mjet pengimi i shfrytëzimit të begatitë të një vendi për vendin tjetër. Ky është parim islam, se Zoti në një vend në Kur'an thotë: "Krijova gjithçka në tokë për juve". Nëse tash ne pengojmë njëri tjetrin se kjo është e këtij fisi apo kombi, atëherë është vepruar kundër mësimëve të Zotit xh.sh..

Respektin më të lartë te Zoti e gëzon ai i cili është më i ndershmi dhe më i moralshmi. Zoti thotë se mendjemadhësia, krenaria e bazuar me gjëra të kota nuk peshon asgjë te Ai. Ai i krijoi të gjithë të barabartë sepse rrjedhin prej një babai dhe një nane. Nuk janë të ndershëm ata të cilët me fuqi shtypin të tjerët, të cilët në bazë të një përkatësie krenohen.

Duhet ta dimë se të ndershëm janë ata të cilët bëjnë vepra të mira, janë të ruajtur prej veprave të këqija, janë të kujdesshëm ndaj njëri-tjetrit. Zoti xh.sh. më së miri di për ardhmërinë e çdokujt.

Ismet Krasniqi. kl. IIb.

SHKO - ROBËRI!

Mjaft qëndrova me ne

të kem mbajtur mjaft.

Kurrë nuk të kemi dashur por...!

Nën mëshirën e fatit qëndrova deri tani

Shko tash, shko!

Shumë njerëz u lindën me ty

me ty edhe vdiqën,

por unë nuk dua të jem prej atyre

që të vdes me ty.

E kaluara të ka mbajtur deri me tani

të mban edhe e tashmja disi

por e ardhmja nuk do të mbajë kurrë.

Dije se kurrë nuk të kemi dashur

Gjithmonë ke qenë mysafir i paftuar

Nuk kemi nevojë për ty

Për ty nuk ka nevojë askush.

Atë të cilën ti na e more (LIRINË) -

ajo do të vijë një ditë.

Shko, pra, shko!

Me vete merri edhe të gjitha të këqijat

dhe... mos u kthe më kurrë!

Shko - Se... nuk na duhesh më

Kurrë nuk kemi pasur nevojë për ty.

Shko!

Muharrem Tërnavë kl. IV

PENDIMI (TEVBEJA) MËNYRË E VETME E SHPËTIMIT

- Vëllezër të dashur muslimanë, ju drejtohem të gjithëve, posaçërisht ty lexues i nderuar. All-llahu xh.sh., na ndihmoftë neve dhe juve, por, me siguri, Ai nuk na ndihmon, po që se ne nuk e ndihmojmë vetvetën tonë. E di dhe të kuptoj se ti je në gjendje të vështirë, sepse edhe ti, sikur çdonjëri tjetër, e ke vesin e lakmisë. Mu për këtë edhe po të flas dhe të këshilloj.

- Fati dhe ardhëria e jetës sate janë në duart tua, varësisht se si i prin ti atij (fatit) në rrugën e pastër të Islamit, apo në rrugën e djallit, mosdëturisë e bestytisë dhe skëterrës.

- Ndoshta të nxitë shoqëria, apo ndoshta edhe vetë djalli, por ti duhet të jesh i vetëdijshëm dhe nuk duhet të pasosh epshet tuaja. Është e sigurtë se epshi të nxitë pas gjërave të pamoralshme, qoftë pas femrave lakurike, qoftë pas lokaleve që shkojnë ato, si nëpër bar, restorant, kafeje etj. Por ti duhet të jesh i vetëdijshëm se këto lokale nuk janë të hieshme e as të moralshme, as për ty as për askënd tjetër. Andaj duhet të mendosh dhe ta kuptosh njëherë mirë se nuk ka shtekdalje tjetër vetëm se dituria dhe morali.

- Të gjithë njerëzit në këtë botë jemi të njëjtë, pavarësisht nga raca, ngjyra, fizionomia. Ajo që e bën njeriun të dallohet nga të tjerët është dija dhe morali. A ke parë ndonjëherë njeri të moralshëm? A i sheh se sa të afërm janë, madje edhe janë të bukur dhe të respektuar nga të gjithë njerëzit tjerë.

Por, ti mos i humb shpresat, sepse edhe ti mund të bëhesh i tillë. Edhe pse ke vepruar gjëra të pamoralshme, e që konsiderohen mëkate, madje shumë lehtë, vetëm duke pranuar dhe zbatuar ligjin e Zotit xh.sh., që vuri mbi njerëz, e ajo është feja. Duhet ta dish se fetë janë të ndryshme, por ti duhet ta zgjedhësh fenë e drejtë, e ajo është feja islame, e cila është fe e vetme e pranuar te Zoti i Madhërishtëm. E jo të marrësh ndonjë fe tjetër e të kalosh nga mëkati në mëkat.

Tani vëlla i dashur, më duket se i ke kuptuar këshillat e mia, andaj kthehu e pendohu, njëherit hyr nën hijen e Islamit, jeto me kënaqësitë e Kur'anit, puno dhe vepro sipas porosisë dhe traditës së Pejgamberit a.s, mëso, studio e mos u bërë njeri neglizhent, i vrazhdë dhe injorant. E në qoftë se frikësohesh se nuk ka shpëtim, meq ke vepruar keq më parë dhe se ato gabime nuk falën. Atëherë ne të garantojmë se do

të të falen ato gabime dhe se ti do të shpëtosh. Këtë garancë ne nuk e jepim sipas hamendjes apo nga dëshira e flakët për të shpëtuar ty, por për këtë na ka treguar Zoti i madhërishtëm, ku në librin e tij thotë:

"Kush bën prej jush ndonjë të keqe pa dije e mandej pas asaj të (keqe) pendohet dhe përmirësohet, s'ka dyshim se Allahu është Ai që fal shumë dhe është mëshirues".

(El Enam: 54)

- Ky është pendimi i singertë, vëllau im i dashur, që të larguarit me të vërtetë nga ajo që ke vepruar më parë, duke e zëvendësuar një të keqe me të mirë pas pendimit. Dhe ta lutësh Zotin xh.sh., që ta falë atë mëkat. Edhe Pejgamberi a.s., na ka treguar, ku thotë në hadithin e tij: "Çdo bir i Ademit (d.m.th. njeriu) është mëkatar, por më i miri prej tyre është ai i cili pendohet". Prandaj, vëllau im i dashur, mos u vono se vonesa për në Islam të sjellë kokëqarje, mos u frikëso fare nga të tjerët, sepse Zoti është Ai i cili të krijoi, të caktoi rrizkun të mbron dhe të shoqëron në këtë botë, por edhe në botën tjetër.

- Në qoftë se mendon se ka kohë për t'u penduar, gabim e ke, sepse vetëm Zoti xh.sh., është ai i cili i jep jetë njerëzve dhe i bën ata që të vdesin, e kur vjen vdekja, pendimi nuk pranohet, e për këtë i Madhi Zot xh.sh. thotë:

"Nuk është pendimi (tevbeja) pendim i atyre që veprojnë derisa ndonjërit t'i vijë vdekja, e ai thotë: unë po pendohem tani".

- Ky pendim nuk pranohet sepse po të pranohej atëherë çdonjëri do të pendohet kur t'i humbë shpresat e jetës. Në këtë mënyrë veproji edhe Faraoni i cili e konsideronte veten "Zot" në kohën e Musait a.s.

- Të këshillon për zemërsisht vëllai ytë musliman, shpejto në rrugën e shpëtimit! E lus All-llahun xh.sh. që t'i ndihmojë të gjithë ata të cilët janë të zhytur në mëkate, që t'u pranojë pendimin e tyre dhe t'i udhëzojë në rrugën e shpëtimit.

- Paqa, mëshira dhe shpëtimi i Zotit xh.sh. qoftë mbi të gjithë muslimanët anë e kënd botës, kudo që janë.

Driton Morina kl. IV

TË PËRSHËNDES PREJ SË LARGU

Kam një vit që nuk jemi parë. Nuk jemi dëgjuar as përmes telefonit. Jam shumë e mërzhitur. Vendosa që ta shkruaj një letër, për ty, vëllai im i dashur. Kjo letër, sado pak, do të më qetësojë. Mua më duket që kurrë nuk të kam parë, të parafytyroj, të ëndërroj në gjumë, jam e mërzhitur shumë Kosova me duket se ditë e përditë është duke u zbrazur.

Vallë, a thua ku je tash? - Në hajm, në punë apo në rrugë, ku të dijet unë se ku je tash? Ah kurbeti, i treti të gjithë shqiptarët.

Me padurim e pres ardhjen tënde, kurrë nuk do t'i shlyej nga kujtesa ime, momentet kur u largove në kontinente tjera, krejt në një botë tjetër.

U largove nga familja, prindërit, motrat, shokët e shoqet, nga bankat e shkollës, nga mbrëmja e matures. I le të gjithë me lot në sy. Për mua, dhe për gjithë familjen, çdo gjë është e errët pa ty vëllai im i dashur. E di se, edhe ti mendon për mua qysh mëndoj unë për ty ditë e natë! Çka na duhen neve ato të holla, kur ti e humb jetën në kurbet?!

Netët dhe ditët janë shumë të gjata dhe të errëta pa ty vëllai im i dashur.

Më në fund pajtohem me fatin, ç'të bësh?, fati i kësaj rinie qënka i tillë që dikush të dalë jashtë atdheut e të mbajë mallë çdo gjë.

Ah mërgim i shkretë! të përshëndet motra e dashur me mallë...!

Qefserë Shala Kl.I

PYETJE DHE PËRGJIGJE

Pyetje: *Allahu xh.sh. thotë:*

"Allahu nuk ju dënon për betimet tuaja të paqëllimita..."

(El-Maide, 89)

Betimi në Qaben, nderin, baban, etj., a është betim i paqëllimt, apo është betim i paqëllimt betimi pa ndonjë nevojë në Allahun xh.sh.?

Përgjigje:

Betimi në dikë tjetër pos në Allahun xh.sh. është haram. Pejgamberi a.s. u ka ndaluar muslimanëve që të betohen në baballarët e tyre: "Allahu xh.sh. ua ka ndaluar që të betoheni në baballarët tuaj. Kush do të betohet le të betohet në Allahun xh.sh. ose le të heshtë". Gjithashtu ka thënë: "Kush betohet në dikë tjetër, pos në Allahun, ai bën shirk".

Dënimi është aq i ashpër për atë, se betimi paraqet nderimin e njëmendtë atij në të cilin personi betohet, kurse besimtarit i është e lejuar që, me gjithë mend, ta respektojë vetëm Allahun xh.sh..

Prandaj, nuk është i lejuar betimi në Qaben, por vetëm në Zotin e Qabes. Gjithashtu nuk është i lejuar betimi në Pejgamberin, vëllaun, motrën, varrin e babait të vdekur, nderin, jetën e fëmijëve të vet, atdheun, etj...

Të betuarit në këtë mënyrë është i ndaluar, sepse betimi prezenton dëshminë e besimit të singertë në njëshmërinë e Allahut xh.sh..

Ibn Mes'udi r.a. ka thënë:

"Më me dëshirë betohem rrejtshëm në Allahun, se sa të betohem singërisht në dikë tjetër".

Ai konsideron se shirku ndaj singëritetit është më i keq se rrena e cila thuhet përmes dëshimit të njëshmërisë së Allahut xh.sh., sepse, nëse betohet në Allahun, ai në atë mënyrë e lartëson atë dhe e thekson njëshmërinë e Tij, edhe pse, pasi që është betuar rrejtshëm, mbetet dënimi për rrenë. Mirëpo, nëse është betuar në dikë tjetër, e jo në Allahun, ka bërë shirk dhe do të dënohet për këtë mëkat, edhe pse do të shpërblehet për singëritetin e treguar, por shpërblimi është mizerik (tepër i vogël) në krahasim me dënimin.

Të vërtetuarit e njëshmërisë së Allahut është shumë më e rëndësishme se singëriteti. Për atë muslimanit nuk i është e lejuar që të betohet në çkado tjetër, përveç në Allahun xh.sh..

Mirëpo, ku nuk është betimi i paqëllimtë i përmendur në ajet. Ky betim mund të ndodhë në dy raste:

- Që të përmendet emri i Allahut, mirëpo në të vërtetë nuk është i dëshiruar betimi, sikurse kur thuhet: "Për Allahun, ulu me ne!", "Pasha Allahun, do ta hash këtë", etj. Me këtë nuk është dëshiruar betimi i vërtetë, mirëpo kjo është vetëm çështje e shprehisë dhe zakonisht.

- Që dikush të betohet në diçka që në të vërtetë e konsideron të tillë, mirëpo del e kundërta, sikurse kur shihet dikush në largësi e themi: "Për Allahun, ky është ky dhe ky", e më pas bindemi se është dikush tjetër. Ky person ka menduar, e karahasuar dhe me në fund është betuar për atë që e ka krahasuar të drejtë pasi që ai nuk ka pasur qëllim që të betohet rrejtshëm, kjo nuk konsiderohet mëkat por vetëm betimi i paqëllimtë. Gabim është të betuarit rrejtshëm për ngjarjet e ditura dhe për ato që duhet të ndodhin.

Sipas kësaj, ekzistojnë tri lloje betimesh:

1. Betimi i paqëllimtë (jeminu-l-lagv) për të cilin veç kemi folur.

2. Betimi i rrejtshëm për ndodhitë e kalaura (jeminu-l-gamus). Kështu quhet (folja gameze, jagmisu, gamsun që d.m.th. zhys, lag në, ngul në, etj.) sepse nxit, inkurajon atë i cili e përdor për mëkat në këtë botë, kurse në botën tjetër do ta fundosë, zhytë në zjarr. Ky lloj betimi llogaritet në betimet e rrejtshme, sikurse kur thuhet: "për Allahun nga ti nuk kam marrë asgjë, kurse ai veç ka marrë diçka ose ka huazuar dhe këtë e ka thënë me gjithë mend dhe qëllimisht. Ky është shembull i qartë i betimit të rrejtshëm, i cili është haram.

3. Betimi për ndodhitë e ardhme (jeminu-l-mun'akide) që për shembull personi të betohet se do të bëjë diçka, sikurse të shkojë në ndonjë vend ose të ngjashme mirëpo, pas kësaj atë prapëseprapë nuk e bën, i vetëdijshëm plotësisht dhe me vetëdëshirë.

Shumica e betimeve të cilat përdoren janë të llojit të fundit, si p.sh.: Që me vetëdije të betohemi se diçka nuk do të bëjmë, ndërkaq atë e bëjmë. Ky është betimi i cili kërkon përmbushjen e keffaretit.

Kjo ka të bëjë vetëm me betimet në Allahun xh.sh.. Të betuarit në dikë tjetër, përveç në Allahun xh.sh., është haram dhe për këtë akt keffareti është pendimi i singertë dhe bëria e veprave të mira.

Pyetje: Jam vajzë 15 vjeçare. Familja dëshiron të më martojë për djalin të cilin nuk e dua, sepse e dua një tjetër, andaj ç'të bëj? Më këshilloni!

Përgjigje:

Siç duket, sot, pyetja mbi dashurinë e simpatinë është shumë e përhapur si pasojë e tregimeve të ndryshme, romaneve, shfaqjeve, filmave etj. kështu që vajzat kanë filluar të ecin pas gjurmëve të asaj çka dëgjojnë ose shohin. Frikësohem se shumica e tyre e aktrojnë simpatinë apo ndjenjën për të, kurse në zemër i qeshen asaj, sidomos kur gjenden në këto vite, vitet e pubertetit dhe pjekurisë. Zemra atëherë është e zbrazët dhe shumë lehtë mbushet me fjalë të ëmbëla e të bukura.

Ka, gjithashtu, djem të cilët, fatkeqësisht, këtë e bëjnë sa për t'u dëfryer dhe kënaqen në këtë lojë, duke u lavdëruar me gjithë zërin, se mund të jem sot me një vajzë, kurse nesër me tjetrën, pasnesër me një tjetër e kështu me radhë.

Këshilla ime është që muslimanet të mos i tërheq pamja e jashtme, mirëpo le t'i dëgjojnë këshillat e baballarëve të tyre, nënave, kujdestarëve e të mos hyjnë në jetën bashkëshortore të bazuara në simpati. Për të gjitha, që më parë, duhet menduar mirë, e më pas duhet të vendosim.

Këshilloj, gjithashtu, kujdestarët (prindërit) se janë të obliguar t'i realizojnë dëshirat vajzave të tyre. Babai nuk mund t'i mbyllë sytë para dëshirave të vajzës së tij e t'i konsiderojë ato të pavlera. Nuk duhet ta martojë me atë që ai do, e jo për atë që ajo do, e që personi i tillë që në fillim të martesës të jetë i mërziutur dhe të urrejë edhe vetë mendimin se me personin, i cili i pëlqen vetëm babait të saj, duhet të jetojë tërë jetën. Këtë e them për atë se babai nuk do të jetojë me burrin e saj, por ajo, prandaj është e nevojshme, para së gjithash që ajo të jetë e kënaqur.

Kjo prapë nuk do të thotë se ata dy duhet të jenë të dashuruar në njëri tjetrin para martesës, mirëpo thjesht që të dy të pëlqejnë njëri tjetrin.

Për këtë Islami urdhëron që i fejuari ta sheh të fejuarën e tij sikurse që është e nevojshme që ajo të sheh atë:

"...sepse në atë mënyrë është më lehtë të realizohet një lidhje martesore e lumtur...", sikurse që thuhet në hadith.

Ligji Islam do që jeta të jetë e mbështetur në pëlqimin e dyanshëm. Vajza duhet të jetë e kënaqur, ose nëse asgjë tjetër duhet të jetë e lirë ta shprehë dëshirën e saj ose nëse turpërohet do të bëjë atë që vetvetiu do ta prezantonjë dëshirën e saj, p.sh.: që të heshtë:

"Kërkohet leja nga vajza, e kjo mund të jetë edhe heshtja, kurse e veja është e lirë".

Ato të cilat më parë kanë qenë të martuara krejtësisht haptazi duhet të deklarohen se a janë të kënaqura ose a pajtohen me zgjedhen e bashkëudhëtarit tjetër jetësor. Për vajzën është, që kur të kërkohet mendimi i saj, e bollshme, pasi që turpërohet, të heshtë ose të qeshet, megjithatë nëse thotë: "Nuk dua"!, ose qanë, ajo nuk duhet të detyrohet.

Pejgamberi a.s. ka kundërshtuar martesën e një gruaje e cila është martuar pa pëlqimin e saj. Ceket, gjithashtu, në hadithë se babai ka dashur ta martojë vajzën e tij, përkundër pëlqimit të saj. Ajo iu është ankuar pejgabmerit a.s., kurse ai e ka këshilluar disa herë që të përmbushë dëshirën e babait të saj, mirëpo kur Pejgamberi a.s. e vërejti se është e paluhatur në vendimin e saj, i ka thënë asaj

"Bën ç'të duash!" Ajo atëherë ka thënë: "Unë do të zbatojë dëshirën e babait tim, mirëpo dua t'ua tërheq vërejtjen prindërve tjerë se ata nuk kanë të drejtë ta bëjnë këtë".

Sigurisht me e dëshiruar është që vajza të jetë e kënaqur, mirëpo edhe kujdestari i saj dhe këtë e kushtëzojnë disa juristë islamë në mënyrë që martesë të jetë e plotë.

Në hadith thuhet:

"Cilado vajzë që martohet, pa miratimin e kujdestarit të saj, martesë e saj është asgjë (këtë Pejgabmeri a.s. e ka përsëritur triherë)".

"Nuk ka martesë pa kujdestarin (Përfaqësuesin e vajzës) dhe dy dëshmitarë të drejtë".

Gjithashtu do t'ishte i nevojshëm edhe pëlqimi i nënës, ashtu siç thuhet në hadith:

"Këshillohuni me nënat për bijat e tyre", sepse nëna më së miri e di dëshirën e vajzës së saj dhe vetëm në këtë mënyrë vajza do të hyjë në jetën bashkëshortore e gëzuar dhe e kënaqur. Atëherë edhe babai i saj do të ndahet i kënaqur, edhe nëna, si dhe prindërit e burrit të saj. Pas kësaj martesë nuk mund të jetë e mundimshme dhe e vështirë.

Më së miri është që martesë të lidhet në këtë mënyrë, të cilën e cek edhe vet ligji Islam, kurse Allahu është Ai që udhëzon.

Artan Qalaj KI IV.